**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit**
**Kuvendi i Komunës**

**Nr.** 02-060/01-56206 **dt.** 15/11/ **2023**

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **22.11.2023** (E mërkurë) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 27.10.2023.
2. Raport për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Drenasit për vitin 2023.
3. Raport për përfundimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave Lokale në Komunën e Drenasit.
4. Propozim vendim për mbështetje financiare e Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave.
5. Propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba Nr.030/01-53502 të datës 27.10.2023.
6. Propozim vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.
7. Propozim vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Persona me Aftësi të Kufizuara.
8. Propozim vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
9. Propozim vendim për plotësim ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
10. Të ndryshme.

Drenas, 15.11.2023

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

**Republika e Kosovës**

**Komuna e Drenasit**

**Kuvendi i Komunës**

02 Nr.060/04-56204 dt. 15/11/2023

**PROCESVERBALI**

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **27.10.2023** e cila filloi në orën 10:00.

**Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari**
**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 29 anëtarë:** Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Albulena Saliuku (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK) Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK). Sali Dvorani (DD). *Mungoj Azemine Gjoka, Qendrim Mulaj.*
Të pranishëm ishin edhe **Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, Nënkryetari i Komunës Arben Shala, Drejtor të Drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së zyra e informimit, qytetar.**

Mbledhja filloi punimet me këtë rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 27.09.2023.
2. Raporti Financiar Janar-Shtator 2023.
3. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e caktimit të normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024.
4. Propozim vendim për dhënien në shfrytezim afatgjatë për 99 vite për pronën e paluajtshme të komunës me procedurë të negocimit të ofertës të kompanisë "Frida's Farm"
5. Propozim vendim për dhenien në shfrytezim afatgjatë për 35 vite për pronën e paluajtshme të komunës me procedurë të negocimit të ofertes të kompanisë "TDI Balkans"
6. Draft propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba.
7. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Xhevat Qorri.
8. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Anita Kastrati.
9. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Lirije Prenku.
10. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up ne projektin e Liridon Hasani.
11. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Dorentina Shehu.
12. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Sabahate Gashi.
13. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Argjira Gjinofci.

14. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Viola Dibrani.
15. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Valdrin Istogu.
16. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start up në projektin e Taulant Mziu
17. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Rijon Ramadani.
18. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Gentian Bujupi.
19. Propozim vendim për ndarjen e kapitalit themelor për NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A, Drenas.
20. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit u mbajt me dt. 27.10.2023, ku për diskutim ishin 20 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal.

**Milaim Hajdari Kryesues:**
Hapi punimet e mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal ku njoftoi me rendin e ditës. Përshëndetje për të gjithë, i nderuar Kryetar, të nderuar drejtorë, të nderuar anëtarë të Kuvendit, po fillojmë mbledhjen e rregullt të Kuvendit të komunës, njoftoi me rendin e ditës, a keni diçka në lidhje me rendin e ditës për diskutim?

**Hamit Haxhiu:** Unë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kam paraqitë që në rend të ditës të hyjnë edhe "Flutura Akademi" për mos vazhdimin e kontratës nga komuna.
Kështu që kërkoj që të hyjë në rend të ditës kjo pikë për "Flutura akademi"

**Ramiz Lladrovci-Kryetari i Komunës:** Edhe në Komitet për Politikë e Financa ta kam sqaru se nuk mund të hyn një pikë në rendin e ditës "Flutura Akademi" sepse ajo është në kompetenca vetëm të mijat, nuk është kompetenca të tjera.
Tek të ndryshme mund të diskutojmë sot gjithë ditën deri nesër për atë temë.
Kështu që unë jam kundër ju ftoj me votu kundër, sepse nuk ki material, për me shti pikë në rendit të ditës, "Flutura Akademi" një pronë që e kam dhënë shfrytëzim pronë njëvjeçare.

**Egzona Tërdevci:** Unë veç propozoj që propozimi i kolegut nga DD-ja të hidhet në votim.
Nëse ka vota, hyn si pikë e rendit të ditës, nëse nuk ka vota, na pajtohemi që mos me hy.

**Bekim Lestrani:** a mundesh me përsëritë kërkesën, por unë s'po e kuptoj pse duhet me hy në rend të ditës, apo keni ndonjë propozim konkret, të lutem!

**Hamit Haxhiu:** Bek shumë konkret thashë nëse ka mundësi që "Flutura Akademi" të hyjë në rend të ditës, pikë e veçantë, për diskutim edhe për arsye pse mos me i vazhdu kontratën nga Komuna "Flutura Akademi" kur dihet se në këtë "Flutur Akademi kanë viju mësimet përmbi një mijë e diçka nxënës.

**Ramiz Lladrovci- Kryetari i Komunës:**Për me debatu nuk ka nevojë me hy në rend të ditës si pikë e veçantë, pra, mësohuni me ditë se çka është pikë e rendit të ditës dhe çka mund të bisedohet në pikë të rendit të ditës.
Unë e kam pru një pikë shtesë të rendit të ditës, ku flet për certifikimin e stacionit të autobusëve dhe na kemi obligim detyrim me i nda mjete bazë për me fillu punën ata aty.
Me fol për "Flutra Akademi" institucionit që ia kam dhënë shfrytëzim unë, nuk ia keni dhënë ju objektin, edhe nuk ju ka vazhdu ma pikë të rendit të ditës, kjo as nuk ka kuptim, as është në tij as nuk është në pikën e Asamblistëve.
Në ndryshme pra, jo veç për këtë pikë, por për çka doni

Ta kam shpjegu prandaj edhe në komitet nuk u rekomandu për me hijë veç u ka propozim.

**Egzona Tërdevci:** Ne jemi dëshmitarë që seancën e kalune të pika të ndryshme, në fund kemi mbetë ndoshta tre më së shumti katër vetë.
Vëmendja te pikat të ndryshme është tepër e vogël.
E di që zotëri Lladrovci kryesisht ka qëndru tek pikat e ndryshme, po seancën e fundit nuk ka qëndru.
Në emër të grupit të Lëvizjes Vetëvendosje unë e mbështes propozimin e Profes Hamit edhe është e detyrueshme prej kryesuesit që një propozim që e bën një anëtar i Kuvendit Komunal me e qitë në votim.
Nëse nuk i merr votat, vazhdojmë edhe diskutojmë të pikat e ndryshme, pa kurrfarë telashe.

**Ramiz Lladrovci- Kryetari i Komunës:** asnjëherë nuk kam ik prej pikave të ndryshme.
Unë s'jam i obligum me nejtë as tani në mbledhje për me rregullore.
Unë nuk jam i obliguar me i mbajtë asambleistë të ndryshme, kur s'kanë interes me ngu pika të cilat ngritën, duhet me e kuptu ne asambleistë për çka me shti në pikë të rendit të ditës, dhe krejt me propozu me thanë ktheja "Flutra e Akademisë" jam ai unë që vendosi, nuk jeni ju që vendosni për atë çështje.
Ju vendosni, kur unë ose ju, e propozoni një pikë të rendit të ditës, një pronë, me e dhanë për më shumë se pesëmbëdhjetë vjet deri nëntëdhjetë e nëntë vjet mundeni me shti pika të rendit të ditës sa doni.
Ajo çështje është e mbyllur. Debat mund të bëjmë

**Labinot Halilaj:** Edhe nëse bën naj gabim asamblisti nuk ka tendencë me bo qëllime të këqija, përndryshe bash detyra e asamblistit është edhe nëse është kompetenca ose roli i Kuvendit është mbikëqyrja e ekzekutivit.
Legjislativi është me mbikëqyrë ekzekutivin, kështu thotë edhe ligji, por nëse ka sene që njëfarë mënyre të kenë paqartësi sado qoftë, se kur po është puna, unë shumë herë ju them edhe këtyre kolegëve, atëherë pse s'po thu ja unë vendosi për çështje, nuk jemi na veç për çështje që vendos Kuvendi, por edhe për çështje që vendos ekzekutivi, kemi të drejtë me lypë llogaridhënie prej secili.
Shumë mrena pozitës që e mbanë si asamblist është secili duke diskutu.
Kështu që jemi në rregull, nëse votohet, nëse nuk votohet.
Po mos na fyej me ata ju asamblistët, doni me ditë se s'ka pse mu fyej kurrkush.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci :** për katër vjet e ke udhëheqë këtë Kuvend edhe ke pas një bashkëpunim shumë të mirë me mua, prej që je bo opozitë, është temë tjetër, edhe opozitës i takon me thanë diçka, me thanë unë të kam përjashtu prej partisë edhe prej grupit parlamentar, po qe ajo e drejtë ma ka dhënë mua statuti, andaj po të them pikën e rendit të ditës, me logjikë të asambleistit dhe tonën nuk mund të hyjnë diçka që as s'ka kush ça diskuton, as s'ka kush material.
Ju ma keni votu një rregullore që unë vendosi mbi bazën e kësaj rregullore.
Prandaj, është të pikat e ndryshme që mundemi të bëjmë diskutim rreth kësaj çështje.

**Albulena Saliuku,**
E vlerësoj punën e "Futura Akademi" gjithsesi mirëpo nuk e shoh të arsyeshme me hedhë si propozim, për shkak se sigurisht që na duhet materiale dhe përderisa nuk varet direkt me votën tonë me iu vazhdu kontratat nuk e shoh të arsyeshme për me hedhë si propozim, mirëpo me diskutu të ndryshme gjithsesi që pajtohem.

**Hamit Hazhiu:**
Nëse nuk e shihni të arsyeshme, që unë e vlerësoj shumë më të arsyeshme kur i ndjekim mbi një mijë nxënës programet e "Fluturës Akademisë" unë e propozoj dhe jam pro asaj që të jetë pika e rendit të ditës.
Unë e propozoj që të jetë rendit të ditës si pikë.

**Milaim Hajdari:**
Mirë, atëherë, meqë po insistoni në aspektin procedural po vina në pozitë jo të lakmueshme kem drejtë a s'kem drejtë, realisht hajde po shkojmë do të thotë në votim për pikën e propozuar prej Hamitit.
Kush jeni për me u diskutu në lidhje me "Flutura Akademi"

Po vazhdojmë edhe një herë me, veç të jemi të qartë, jemi kah votojmë pikën e propozuar prej Hamitit për diskutim të "Flutura Akademi" Shkojmë edhe një herë me votim, domethënë për këtë pikë të rendit të ditës.

Do të thotë prej votimit kanë dalë katërmbëdhjetë për, katërmbëdhjetë kundër dhe një abstenim.
Në këtë rast vota e kryesuesit që është kundër, kjo nuk kalon si pikë e rendit të ditës, por mund të diskutohet në të ndryshme.

Kush jeni për këtë rend të ditës?
Për rendin e ditës komplet.
Miratohet rendi i ditës, ashtu siç u diskutu dhe u lexu paraprakisht.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:
**1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 27.09.2023.**
Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 26 anëtar, kundër nuk pati, 3 abstenim.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:
**2.Raporti Financiar Janar-Shtator 2023.**

**Egzona Tërdevci:** I kam disa pyetje tek raporti financiar.
E para është shumë shqetësuese realizimi i investimeve kapitale deri në fund të shtatorit janë realizuar veç tridhjetë pikë gjashtëdhjetë e katër për qind të investimeve kapitale të planifikuara nga Komuna e Drenasit.
Po ashtu në bazë të kësaj, kam disa pyetje për drejtori të veçanta.
Tek Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente është një projekt që është rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese.
Nuk është shpenzu asnjë mjet prej kësaj dhe mbetja është njëzet e tre mijë, domethënë është ndoshta gabim teknik, ose ju lutem sqaroni një diferencë prej katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një euro.
Tek Drejtoria e Infrastrukturës Lokale të ujësjellësi janë realizu vetëm 16.72 % e projektit, nëse mundemi ta sqaru sepse nuk është realizu më shumë punë.
Tek zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit e dimë që ky projekt tash veç sa ka fillu dhe janë shpenzu njëqind e pesëdhjetë mijë euro, nëse ka mundësi një shpjegim për këtë çështje.
Po ashtu, te asfaltimi i rrugëve dhe kufizimi në Drenas një, dy, tre dhe katër janë ndarë treqind e njëzet mijë euro dhe nuk është filluar ende projekti.
Është e mundur që të fillohet ky projekt deri në fundin e vitit dy mijë e njëzet e tre?

**Ramiz Lladrovci-Kryetari i Komunës:**
Raporti Financiar Janar-Shtator 2023 e kena shpenzu aq sa kena pas mundësi.

**Shyqiri Bublaku Drejtor i Financave:**
Po, është gabim teknik, e kështu është gabim teknik.

**Filloreta Bujupi:** Tek vendimet gjyqësore për kontrata kolektive janë shpenzu mbi pesëqind e katërdhjetë e pesë mijë euro.
Ju lutem, a mund të na sqaroni se a bëhet fjalë për fushën e arsimit, si dhe sa është numri i punëtorëve që kanë marrë këtë shumë?
Po ashtu, keni përmendë se prej të gjitha subvencioneve që keni nda, janë gjashtëdhjetë e pesë gra, gjashtëdhjetë e dy janë individë, tre janë OJQ.
Ju lutem, a mund ta keni marrë numrin e gjithmbarshëm të subvencioneve që janë nda për nëntë mujorin, si dhe sa është vlera e subvencioneve gjashtëdhjetë e pesë gra të ndara?
Tek të hyrat nga qiraja për objektet komunale ka rënie të vlerës krahasuar me vitin dy mijë e njëzet e dy .
A mund të na shpjegoni arsyen si dhe a është ë mund të na njoftoni se sa prona objekte komunale i ka aktualisht komunat të dhëna me qira?

**Drin Halilaj:** Unë kam disa çështje për t'i ngritur raportin.
E para është vlera e të hyrave nga taksa për leje ndërtimi, është mbi njëqind e pesëdhjetë mijë euro.
A mund ma shpjegoni se sa leje ndërtimi janë dhënë? Tjetra tek shpenzimet ka rritje tejet të theksuar nga nëntë mujori i vitit 2021-2022, a mund ta shpjegoni arsyen e rritjes së kategorisë mallra dhe shërbime? Tjetra, shpenzimet komunale janë rritur nga 135,396.00 euro sa kanë qenë në vitin 2022 në 171,467.00 euro për vitin 2023. Apo ne përqindje 127 %. Ju lutem, a mund ta shpjegoni pse janë rritur këto?

**Egzona Tërdevci:** Unë pata çështjen e investimit të shpenzimeve kapitale, vetëm 30.64 shpenzim.
Tek drejtoria për shërbime publike dhe emergjenca u sqarua që është një gabim teknik, se mungon një vlerë katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një euro, tek infrastruktura, tek projekti për ujësjellësin, si janë realizu vetëm 16.72, tek zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit, deri në fund të muajit shtatori janë pagu njëqind e pesëdhjetë mijë euro, pse realisht nuk ka pas punime të fillume deri në atë kohë është edhe është projekti asfaltimi i rrugëve dhe kushtëzimi në Drenas një, dy, tre dhe katër që janë ndarë treqind e njëzet mijë euro dhe nuk është shpenzu asnjë cent, a është e mundur që ky projekt të kryhet deri në fundin e vitit dy mijë e njëzet e tre, ashtu siç është planifiku?

**Ramiz Lladrovci-Kryetari i Komunës:**
Jo pesë gjashtëqind mijë, kena pagu mbi gjashtë milion euro për kontrata kolektive.
shujta edhe kontratë shpenzimeve të udhëtimit e krejt për ata paga jubilare, paga pensionale, për ata unë e kam paditë dy ministri të Qeverisë së Kosovës, të cilat kanë bo kontrata në kundërshtim me ligjin në dëm të komunave.
Leje ndërtimi besoj që të japin përgjigje dikasteri se nuk i numëroi lejet e ndërtimit.
Shpenzimin në rritje të komunalisë.
Nëntëdhjetë për qind gati e kanë bo ndriçimin publik.
Ajo është shpenzim i komunalisë.
Pra, na shpenzojmë edhe rrymë edhe shpenzime tjera, plus shtrejtimi i rrymës.
Në infrastruktura: aq sa kena shpenzu, kena harxhu, është temë me përqindje prandaj edhe vlerësohem në bazë të investimeve me mujt t'i shpenzoj njëqind për qind, po s'kam mujt për shkak të procedurave dhe gjyqësore, procedurave të OSHP-së edhe procedurave tjera, sheshi dhjetë për qind të kontratës e kam marrë tash po ma raportojnë edhe dua se unë këto nuk i di edhe nuk i kam nënshkruar, pesë përqindëshi, a dhjetë përqindëshi i kontratës lejohet me ligj.
Me ligj lejohet dhjetë përqind, por kur është tre muajt e fundit, katër muajt e fundit, vjen në pesë përqind.
Është e lejueshme me ligj edhe na e kemi, e kemi akceptu atë vendim.

**Mehedin Salihu:** Ishte një pyetje për drejtorin.
Më intereson pse me ba ka shpenzime ose pse njerëz në sektorin publikt arsimit, shëndetësisë e tjerë, duhet që një të drejtë të vete ta realizojmë përmes përmbaruesit, kur dihet se kjo kosto i kushton shumë ashtu reja të komunës.
Pse nuk jua mundëso këtë të drejtë me realizu pa përmbarues privat, edhe e keni ma lirë edhe nuk maltretoheni ju as individi.

**Ramiz Lladrovci-Kryetari i Komunës:** Këta të Vetëvendosjes mujnë me marrë procesverbalin e takimeve me qeverinë që i kena pas. Edhe ngaqë pyetje sikur ti e kena ba, po pyetje edhe jotja edhe jemja, më paksi pa lidhje, sepse një kontratë që lidhet kundërshtim me ligjin nuk mund të kryhet ndryshe përveçse me i ndjekë këto procedurat e përmbarimit.
Unë i kupton ministrit të Financave, zoti ministër na jepni këtë, e kumi pagu qito që të mos paguajmë edhe përmbarues, sepse po shtohen, ajo thotë s'muj me të dhënë këtë se nuk është në pajtim me ligjin.

**Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari:**
Ky raport këtu nuk votohet, kalojmë tek pika tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e caktimit të normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024.**

**Labinot Halilaj:**
A janë në harmonizim me ligjin që njëfarë mënyre deri tash kena ba pagesa në tatim pronë?

**Shyqiri Bublaku-Drejtor i Financave:**
Janë të harmonizume me ligjin se kemi marrë arsyetimin prej departamentit tatimit të pronë që kuvendet komunale kanë mundësi me zvogëlu normën tatimore prej zero pesëmbëdhjetë deri që ka qenë, nen zero pesëmbëdhjetë domethënë na e kemi shfrytëzu mundësinë me bo zero pikë dhjetë, se është në të mirën e qytetarëve tanë edhe pse ne si kuvend komunal i shkurtojmë të hyrat vetanake, mirëpo për një vit nuk është shumë e madhe të mujna me përballu si kuvend komunal.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 28 anëtar, 1 kundër, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për dhënien në shfrytezim afatgjatë për 99 vite për pronën e paluajtshme të komunës me procedurë të negocimit të ofertës të kompanisë "Frida's Farm"**

**Egzona Tërdevci:**
Kryesues, Së pari kisha kërku mirëkuptimin tënd me diskutu për dy pika të njëjtën kohë, meqë të dyjat e kanë qëllimin e njëjtë, dhe janë dhënë në shfrytëzim të pronave, nëse më lejohet, që mos me i përsërisë gjërat e njëjta.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- domethënë kështu vota bëhet por diskutimet mund të nënkuptojnë por të dyja nëse proceduralisht janë të njëjta, atëherë ju ftoj për për diskutim lidhur me këtë.

**Egzona Tërdevci:** Atëherë e kam së pari një dilemë tek Fridas Farm.
Të Fridas Farm treqind e nëntëmbëdhjetë euro qysh e dimë është qiraja vjetore, po tek informacionet që na i keni përcjellë keni thënë që treqind e nëntëmbëdhjetë euro është qiraja vjetore si në Gjermani.
Ky është informacion investitorit.
Nuk kisha besu që duhet me marrë për të mirëqen një informacion që s'e keni të konfirmu.
Nuk po besoj që keni bo hulumtime në Gjermani për me verifiku nëse e njëjta është edhe tek, e dyta është pagesa që rast fillon nga punimi i fillimeve i fillimit të punimeve ose nga marrja e lejes nga ZRRE-ja, varësisht cila vjen e parë: a kemi një konfirmim prej kompanisë se kur fillojmë punimet ose a ka apliku tashmë zyrtarisht për leje nga ZRRE-ja.
Po ashtu, në emër të Grupit të Asambleseve të Lëvizjes Vetëvendosje, unë propozoj që koha e dhënë në shfrytëzim për këto dy prona, të jetë njëzet vjet.
Njëzet vjet është e mjaftueshme për me pa nëse kanë me u zhvillu si biznese, nëntëdhjetë e nëntë vjet është kohë tepër e gjatë, po ashtu edhe tridhjetë e pesë vjet është kohë tepër e gjatë dhe për korrektësi, jeni dëshmitarë të gjithë që unë ju kam pyetur në seancën e kalune për kohën asnjëherë nuk është diskutuar afat kaq i gjatë.
Asnjëherë.
Kam pyet për të dyjat, edhe për Fridën, edhe për të TDI, ka pas paqartësi, është përfolë herë pesë, herë njëzet, po asnjëherë nëntëdhjetë e nëntë, asnjëherë tridhjetë e pesë.
Ne jemi pro investimeve të huaja dhe i mbështetim zhvillimin ekonomik të qytetit.
Në situatën kur është më njëzet vjet, ë grupi i asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje jep mbështetje për këto dy propozime.
Për tridhjetë dhe nëntëdhjetë e nëntë nuk mundemi me mbështet këtë propozim vendim.

**Ramiz Lladrovci-Kryetari i Komunës:**
Unë as që s'kam bo negociata, as që jam kanë takime, të vetmet takime ku kam pas që e kam obligim me ligj me bo një takim me i harmonizu këto që janë bo me me të zgjedhurit e Kuvendit që më kanë rekomandu, na mund ta votojmë.
Unë them që tash po i votojmë për njëzet vjet
Po kompania e cila e ka lyp afat ose e ka lyp kohë sa e donë pronën në shfrytëzim, ajo munet me thanë nesër unë nuk lidhi kontratë, sepse na e kemi kërku tridhjet e pesë vjet edhe mu investimin që i kam prej njëzet e nëntë milionë e gjysmë afërsisht me investu, unë investoj për tridhjet e pesë vjet, sepse unë e nxjerri e nxjerri investimin tim, por për njëzet vjet ai s'mundett me nxjerrë edhe nuk investon tash nëse jeni për me me e dhanë pronën jepni, nëse nuk jeni, atëherë me ndërru këto tema, të cilat i keni diskutu vetë grupet e juve parlamentare, për të cilët i keni caktu, nuk është e drejtë, sepse ka edhe një procesverbal të mbajtur edhe me juve edhe me mua.
Kështu që unë jam sot doni me ja dhanë bo ata nuk e lidhin kontratën, pastaj ne çka bëjmë?!

**Egzona Tërdevci:** z.Lladrovci nuk do të thotë që me ndërprerë bashkëpunimin me atë kompani, u mund me lanë me një klauzolë të veçantë, ku mund t'i vazhdohet kontrata.
Po me ju dhanë parim prej tash për tridhjetë e pesë edhe për nëntëdhjetë e nëntë për bindjen tonë si asamblist, është kohë tejet e gjatë.
Tash, ju e vlerësoni, na e tregum qëndrimin tonë është plotësisht e juaja sesi dakordohet.

**Ramiz Lladrovci-Kryetari i Komunës:**E sqarojmë saktë, as po ia kërkoj me votu, as mos me votu Nuk kam kësi telashe, në qoftë se ju vendosni, negoconi, më rekomandoni, unë i zhvilloj procedurat, i sjelli këtu.
A janë profitabile a punojnë ato, është në dorën e tonë, kur s'punojnë me ia marrë pronën kaq.
Domethanë është në dorën tonë qat moment që nuk i përmbahet kontratës, është në dorën tonë me ia marrë kontratën.me ia marrë pronën, nuk është në tyne, edhe me ia marrë bile mas zhvillimit që ka bërë një zhvillim e që është një aset shtesë për neve. Komuna ose Ligji për dhënien e pronave në shfrytëzim thotë: Jepet prona dikujt që ia rrit vlerën, një dikujt që ia zvogëlon.
Pra, na gërthyes sikur në Golesh që e kemi ba nuk mund t'ia jepim kurrkujt, sepse ia ul vlerën se na kena plot prona për atë temë po na nuk kena nuk na leja ligji.
Pra, ju ftoj me votu si pas negociatave që i kanë zhvillu grupet parlamentare me investitorë edhe sipas asaj që është marrë një dokument.
Ju ftoj me mi votu.
Ju votoni qysh qysh doni.
Po, unë prapë po thom, nëse unë po propozoj qitash, unë s'muj me propozu, sepse s'muj me ia nderru kohën ose vitet të cilat i ka kërku një pronar, i cili e ka investimin e vet e ka para llogaritë.

**Hamit Haxhiu:**
Ne e kemi mbajt një mbledhje për këtë çështje, është edhe procesi, që e ka nënkryetari, ku Florentina me sa e di unë nuk k qenë prezent, do me thanë edhe krejt këtë punë çka është duke të diskutu tash na e kena diskutu edhe mbledhjen e fundit dhe kena diskutu komplet sa është investimi sa do të jetë fititimi, sa do të jetë për sa vite do të jetë për dy kompanitë që janë kanë me investu.
Kështu që unë nuk po e shoh të arsyeshme me diskutu për këto kur e kemi edhe një proces.

**Egzona Tërdevci:**Unë e kam në dorë raportin e datës tridhjetë e një, tetë, dy mijë e njëzet e tre, që e ka dërgu nënkryetari tek ekzekutivi lidhur me takimin që është mbajtë.
E para, thuhet këtu në raport, në faqen e parë, që me datë të parin, tetin, dy mijë e njëzet e tre, anëtari i Komisionit nga ekzekutivi, Arben Shala, ka dërguar email për përmbledhjet e kërkesave të pranuara për negocim pra nuk qëndron që komisioni ka negocu me investitort, po këtu i kem sqarimet për dy kompanitë, po asnjëherë nuk është i cekun afati që kanë pas me marrë në dhënie në shfrytëzim.
Këtë kërkesë e kam ngritë edhe në seancën e kaluar, por besoj që kërkesa jem është shumë legjitime, komisioni nuk na ka dërgu kurrfarë afati.

**Bekim Lestrani:** Po mendoj që këtu mos kemi pse me diskutu, e kena votu e kena votu qysh seancën e kalune, e kena diskutu edhe të gjitha opsionet që janë tash këtu, nuk e di pse tash na duhet me humb kohë.

**Egzona Tërdevci:**Këto gjana që po i sqaron tash, a bëni ta bëj një pyetje krejt legjitime?
Cili është kuptimi me zgjedhë një komision prej kuvendit komunal, nëse fjala e atij komisioni prapë nuk është e fundit, se të diskutimi i komisionit, të raportit që na e kemi këtu, është raporti i datës 31.08 kurrkund nuk është i përmendur afati, as nuk është nëntëdhjetë e nëntë vjet, as tridhjetë e pesë vjet.
Nëse po bëjna komisione veç sa për sy faqe i leme krejt këto komisione.

**Ramiz Lladrovci-Kryetari i Komunës:**Nëse një gabim teknik ka mbetë as po atje ka një ditë, as një vjet, as dhjetë vjet, as nëntëdhjetë e nëntë vjet në raport të komisionit, pra është komisioni që nuk e ka përfshi ose gabimisht, ose teknikisht.
Pra, jam ai që unë që i mbuloj këto defekte.
Unë s'guxoj me gabu, sepse unë jam ai që i nënshtroj dhe unë mbaj përgjegjësi para ligjit, nuk mbani ju.
Prandaj, ju ftoj a votoni për ose kundër propozimet që i keni aty.
Unë sinqerisht ju them që komisioni ka bo punë të mrekullueshme, më ka rekomanduar, siç ai në këtë temë.
A ka nevojë vendi mu zhvillu?
Ka nevojë.
A ka nevojë me u investu gjithë ato mjete?
Ka nevojë.
Kjo është tema.

**Beqir Kiqina:** Propozim-vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetë e nëntë vite për pronën e paligjshme të komunës në procedurë të negocimit të ofertës së kompanisë Frida farm, edhe pika tjetër:
Propozim-vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për tridhjetë e pesë vite në pronën e paligjshme të komunës në procedurë të negocimit dhe të ofertës të kompanisë "TDI Balkans" Këto dy pika i ka trajtu domethënë komisioni i cili është formu prej këtij do të thotë Kuvendit Komunal, së bashku me nënkryetarin e komunës që është kryetari i komisionit domethënë nga ekzekutivi edhe kemi edhe janë sjellë edhe në muajin e kalum, domethënë seancë për shqyrtim.
Të gjitha ato janë diskutu edhe ne si Komision, të gjithë prezentë.
Sa kemi qenë Komision i kemi votu, do të thotë edhe kemi qenë të gjithë të mendimit që këtu me ardhë në Kuvend për trajtim.
Me sa të kuptoj edhe kujtoj në seancën e kalume kanë qenë disa çështje procedurale dhe që kanë ardhë përsëri edhe sot.
Mendoj që komisioni që the pse duhet me votu komisionin, pasi që i ka kompetencat.
Komisioni nuk i ka komplet kompetencat.
Ajo i ka vetëm për dhënie domethënë ose për propozim ndaj kryetarit.
Nuk mundet me kalu vetëm Komisioni, por edhe këtu në Kuvend.
Të gjitha këto po kemi mendu ne si Komision, që kemi qenë prezent që janë në interes të qytetarëve, andaj kemi propozu kështu si në vijim dhe ne si Komision, me plot përgjegjësi kemi vendos që me dhanë do të thotë ë leje për ë investim për vitet që i kemi të cekura.

**Labinot Halilaj:**Unë personalisht, edhe kur është themelu komisioni, se s'kam qenë pro këtij komisioni hiç, edhe tash ju si komision, kolegët mi dhe ju ish dashtë me ardh me një raport për Kuvendin kur është diskutu kjo pikë e rendit të ditës, asgjë si anëtarë të komisionit dhe si komision, s'e keni pru asnjë raport me njoftu Kuvendin për mbarëvajtjen e këtyre sendeve dhe tash njëfarë mënyre, ju po diskutoni çështje që po keni qef me i diskutuan.
Faktikisht, asnjë diskutim s'e keni pas me atë që që njëfarë mënyre me përmbledhë qysh ka ardhë deri këtu, pse ka ardhë deri këtu, a është me interes me u votu, a s'është me interes me u votu.
Domethënë e keni kry punën e juaj, po si komision s'keni ardhë me një raport që në diskutim edhe me ekzekutimin bashkërisht me tha okej, deri këtu kemi shku mirë, deri këtu e kemi pas siç sa në rregull edhe

njëfarë mënyre njëfarë mënyre të thjesht me ia bo qytetarëve dhe neve ma të qartë këtë propozim-vendimi.
Është fakt si pronën as mujna me dha për pesë vjet, se asnjë investitor s'na merr për pesë vjet pronën.
Këtë nuk ka diskutim.
Por një gjë nuk e kam të qartë.
Thuhet me i dhanë solar.
Në rregull me i dhënë solar po qysh është mëndu kemi dhënë solar një herë të jepet prona, me pronë tonë të aplikon në ZRRE, ZRRE-ja vendos për ose i kundër me ia dhanë, për shkak që ka mundësi t'i mos t'i plotësoj kushtet, aty ka aty ka procedura profesionale.
Edhe tash në njëfarë mënyre ia dhanë, po ZRRE-ja refuzon edhe në fund çka dhanë?
Thjesht ë, unë e kam diskutu edhe për pronat e mëhershme, na duhet me pas një raport kryetar edhe për pronat e kalune, si kena edhe duhet me pas raportin, është obligim i juaji
Edhe tjetra, është mirë me ditë na e afatet se unë personalisht jam për investime, edhe jemi për zhvillim, na me herët kolegët e tjerë e ceken "flutura në akademinë", nuk është zhvillim kjo, para ditëve me më mbyll diçka, mas jo, edhe thjesht thjesht zhvillimi është nocion i gjanë edhe përmendjen për zhvillim, po duhet me ditë saktësisht edhe na çka po dojmë si komunë edhe na kur dojmë pronën dikujt me ditë ça po përfitojmë si komunë dhe është me ditë është mirë secili me ditë përgjatë pronë për publike përgjatë pronë publike me ditë secili ça janë përfitimet, ça janë dëmet që nëse jepen ose nëse nuk jepen.
Unë prapë kam vërejtje dhe qëndroj edhe pro atyre vërejtjeve të Komisionit, që Komisioni, ky Komision, s'ka ardhë as me një raport për neve si kolegë, edhe pse kanë dashtë me kanë pjesë në këtë Komision, në lidhje me rekomandimet për dhënie të pronave.

**Ramiz Lladrovci-Kryetari i Komunës:** Lab, Komisioni ka ba raport, kena debatu për këtë çështje dhe si rezultat i disa mos qartësive që po i përmendni, edhe për sport e kena shty për këtë mbledhje.
Pra, ka bo raport.
Ka pas raport.
Edhe nëse investitori ka me marrë lejen prej ZRRE-së, sepse kurrkujt që vyen prona me marrë me të pagu ty, nëse nuk ia jep lejen ZRRE-ja.
Unë nuk paragjykoj a ia jep lejen, as që ia jep lejen është çështje e ndarë, por ai konsideron që ka marrëveshje kontratë në momentin që e merr lejen prej ZRRE-së.
A kena procedura që kena me i dërgu në vlerësim ligjor?
Ndoshta na i kthehen krejt negativ, unë nuk e di, po unë pa humb kohë ju ftoj të votoni propozimet mbi bazën e rekomandimeve të anëtarëve të grupeve parlamentare të Kuvendit të Komunës së Drenasit.

**Beqir Kiqina:**
Sa i përket dhënieve të pronave në shfrytëzim, do me thënë ë pasi që e përmendi Labi raportin, është sjellë raporti, po edhe vetë është njëfarë lloj raporti edhe materialet që e sqarojnë domethënë ndonjërën e pronave në shfrytëzim edhe është diskutu edhe kemi mbajtë mbledhje të rregullta, janë prezantu, e kemi shiksu edhe po qa jashtë aty më shumë se ty njëqind mbledhje nuk mbahen për dy.
kemi mbajtë mbledhje, njëjës është kjo.
Nuk thashë mbledhjet, a po më kupton, ndoshta me marr pak më serioz çështjet edhe ti ke mungu nëse nuk gaboj, edhe t'ju duhesh me ardh aty, me qenë prezent edhe me diskutu edhe me votu për, kundër ose abstenim.
Kështu që ne i kemi diskutuar, raporti ka dhe është edhe përgjegjësi, do të thotë edhe kryetarit të domethënë Komisionit me i sjellë apet dhe ose edhe me ta bë forward përsëri edhe në e-mail këtu.

**Florentina Elezi:** Deshta me u lidhte ky diskutim, sidomos te fjala e shefit të Grupit të PDK-së dhe të AAK-së. Nëse e keni përpara procesverbalin e mbledhjes kalume, është shumë e qartë ku ka pyet Egzona, ka thënë sa vite ka me u jep për Frida Farmës, edhe asnjë përgjigje nuk u kanë.
S'ka qenë përgjigje fikse për sa vite.
Ja, është procesverbal, e kena krejt, e keni krejt përpara po ju duket disa asambleistëve se është humbje kohe, por kjo është një pyetje që nuk kena marrë përgjigje, ndërsa sot ka ardhë për nëntëdhjetë e nëntë vite.
që është tepër shumë për neve dhe që nuk pajtojmë, domethënë nuk është nuk ka kurrgjë risi dhe gjithashtu

nuk janë du të përsërisë pyetjet dhe paqartësisë që e kemi pas në seancën e kalune, për shkak se ato veç i kemi sqaru një arsimi dhe kemi kuptu sot domethënë jena tu e ngritë një çështje krejt siç tjetër, për të cilën nuk kemi marrë përgjigje deri tani.
Nashta, dikujt u duket humbje kohe, ama ne jemi këtu për interesa të përgjithshme të qytetareve.

**Ramiz Lladrovci-Kryetari i Komunës:** Unë e thashë, është e saktë qka ka pyet Egzona
Prandaj, procesverbalin e kam zhvillu edhe e keni para veti sa kanë kërkuar e sa kërkojnë.
Mujsh me i bind këta, i bind me votu kundra, mu s'ma prish as as për as kundra, në qoftë se këta e vlerësojnë që është pozitive, e votojnë për.
Në qoftë se nuk e vlerësojnë, e votojnë kundra.
Nuk nuk jena çka diskutojmë.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** A ka dikush tjetër në lidhje me këtë pikë për diskutim?
Meqë nuk pati diskutime, tjera kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 24 anëtar, 4 kundër, 1 abstenim.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: 5. **Propozim vendim për dhenien në shfrytezim afatgjatë për 35 vite për pronën e paluajtshme të komunës me procedurë të negocimit të ofertes të kompanisë "TDI Balkans"**
Meqë nuk pati diskutime, tjera kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **"Për"** votuan 24 anëtar, kundër nuk pati, 5 abstenim.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: 6. **Draft propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba**

**Florentina Elezi:** Kjo pikë e rendit të ditës na kemi kërku që me u shty për edhe një seancë, për shkak se e kemi pa që mundemi me i bo disa ndryshime.
Disa propozimeve që i kemi ba po nuk janë aprovu në Komision për shkak se kanë thënë që nuk përputhen me ligjin, ashtu siç më tha edhe Kryetari në Komitetin për Politikë dhe Financa.
Ndërsa, unë sot në emër të Grupit të Lëvizjes Vetëvendosje po propozoj që na e di në situatën e bizneseve në Drenas, janë me një situatë jo shumë të mirë, inflacioni siç është në rritje për të gjithë ne është edhe për biznese, ato kurrë më shumë se sot nuk kanë nevojë për ndihmë, ashtu kështu nuk është se kemi komedi sa të ardhura nga taksat një e bizneseve, kështu që propozojmë që për një vit ose tri vite me ia heq taksën komunale me ia ba zero ose ose një shumë simbolike, për shembull dhjetë euro, e jo më shumë, për shkak se bizneset kanë nevojë shumë për ndihmë dhe propozimi jonë është që me u heq taksa komunale për këto biznese.
Përndryshe, ne duhet të abstenojmë apo të votojmë kundër kësaj rregullore.

**Ramiz Lladrovci-Kryetari i Komunës:** E nuk mujna me marr vendime me liru prej taksave ata që janë të përcaktume me me ligj.
Edhe mbi bazën e vlerësimeve që janë ba nga Zyra e Financave për të hyra, e kemi miratu edhe buxhetin.
Kjo dini që dy vjet nesht i kemi falë këto obligime, sepse u kanë pandemi, u kanë një kanë përndryshe, për çdo pikë ju jap ë përgjigje ë drejtoresha dhe drejtorët tjerë.
Unë nuk jam një arsye mirë i kësaj, duke thënë po Unë ju ftoj me votu, sepse në rast se s'e votojmë, i bie që na kena me punu edhe një vit tjetër me rregulloren e vitit të kalum që është ma diskriminuese për bizneset sesa kjo, edhe për për shërbime tjera.

**Florentina Elezi:**
A bon veç me ditë me cilin ligjin e thirr që nuk po muj shumë me ia bon zero taksën komunale, për shkak se unë kam na kena shikuar si grup dhe nuk është se kemi bo nuk e di na kishte në qoftë se ka një ligj që nuk na lejon, ju lutem tregona.

**Ramiz Lladrovci-Kryetari i Komunës:** Ligji për vetëqeverisje lokale është ligji bazë, ligji kryesor si asnjë ligj tjetër.

**Beqir Kiqina:**
Unë një pyetje, kolege, e nderuar, pasi e paraqiti domethënë propozimin për lirim nga taksa e bizneseve, apo për cilat biznese, të vogla, të mesme apo të mëdha, apo të gjitha komplet.

**Florentina Elezi:**
Bizneset individuale, po edhe ato SHPK

**Egzona Tërdevci:**
Komentet që i kemi dërgu për konsultim publik na është dhënë arsyetimi se nuk ka bazë ligjore për me i marrë komentet tona.
Tash po thoni që ligji bazik në të cilin jemi thirrë për këtë rregullore, tu i përfshi edhe edhe taksat për biznese është Ligji për vetëqeverisje lokale.
çka lë me nënkuptu që është plotësisht në domenin tonë si komunë që me vendosë a kanë me pasë taksa bizneset a jo.
Ne kemi hulumtu edhe rregulloret e komunave tjera, përderisa një qytet industrial që është shumë i zhvillum si Ferizaji ka zero taksa për ushtrim të veprimtarive biznesore, është pak e padrejtë për bizneset e Drenasit me i paë ato taksa.
Ju e vlerësoni vetë dhe në fundi kanë me vlerësu qytetarët që janë edhe përfaqësuesit e atyre biznesit po është pa drejtësi edhe si kuvend komunal, pa dallim prej grupeve politike, në të cilat bëjmë pjesë, nuk na kushton kurrgjë me ja plotësu barrën që edhe ashtu e kanë të madhe bizneset e Drenasit.

**Ramiz Lladrovci-Kryetari i Komunës:** unë jam kanë për pikat e juve, po nuk mund me u implementu, për shkak se ato janë tarifa fikse që i ka vendosë niveli qendror, pra Ligji për qeverisje lokale dhe Ligji për financa.
Unë nuk i di për çdo për çdo pikë, po me thanë Florentina me i liru bizneset individuale BI, që janë kompani të fuqishme, po ju ka mbetë BI, sepse janë procedura mu bo korporatë, kurrfarë taksë nuk kanë, e kena obligim me bo Rregulloren, propozoni nëse ua votojnë këta tjerët, në rregull je na nëse është në harmoni me ligjin.

**Mehedin Salihu:**
Unë po flas cilësinë e anëtarit të Komisionit që kam qenë për hartimin e kësaj Rregullore.
I kena dhënë një mori të vërejtjesh,po nuk janë marrë parasysh.
Ndoshta nuk është mundësia me i fal krejt, po bile është mundësia me i reduktu.
Sa i përket tarifave fikse që po thotë kryetari nuk janë fikse, në shumë komuna tjera janë shumë më të ulëta se të na, bile ato janë simbolike.
Kam edhe dëshmi që e kam nxjerrë këtë listën, nuk po flas veç pse po më pëlqen mua. Unë kërkoj që nëse nuk mund me i folë, bile t'i përgjysmojmë.
E vetmja zgjidhje është që këta njerëzit me dalë prej krize, është me ia lehtu pak na.
Kena mundësi.

**Ramiz Lladrovci-Kryetari i Komunës:** propozimi i Vetëvendosjes nuk u kanë për me ule e me ngritë taksat. U kanë se nuk kanë thënë si kë na ndjek këto procedura.
Dhe, procedurat u kanë që nuk na mbajt Dëgjime për këtë çështje
Pra, prej rregullores tjetër është kjo rregullore më e favorshme për bizneset në komunën e Drenasit dhe për taksat, tarifat e tjera që janë në ty.

**Labinot Halilaj:** cilat janë përparësitë e kësaj Rregullores, karshi Rregullores të kaluar?
Cilën janë përfitimet e bizneseve në kësaj Rregullore, prej krahaso ndryshimet që janë ba në Rregullore?

**Egzona Tërdevci:** Në emër të grupit, realisht kolegia jonë Florentina Elezi e bën një propozim për zvogëlim të taksave për biznese ose heqje të tyre fare.
Nuk e morëm një argumentim se pse nuk mundet mu ba ajo.
Nëse ka mundësi, qoftë drejtoresha, qoftë zotëri Lladrovci, ne ta japim një sqarim se pse nuk mundet mu ba.
Nëse mundet mu ba, ju lus që paraprakisht propozimin tonë me hedh në votim para Rregullores, edhe nëse Rregullorja miratohet me ndryshime, atëherë vazhdojmë.

**Ramiz Lladrovci-Kryetari i Komunës:** Drenas, bizneset e të vogla janë të lirune prej tatimeve, Drenas, pra në bazë të kodeve, bizneset e vogla në bazë të kodeve, na nuk mund na me i nderru, janë të lirume me me rregullore
Të gjitha bizneset që deklarojnë me zero në ATK, janë të lirume.
Të tjerat që janë të regjistrume si BI, janë SHBK që kanë qarkullime tepër të larta brenda vitit, pra BI e ka qarkullimin të lartë brenda vitit.

**Hamit Haxhiu:** Edhe unë propozoj që për vitin 2024 me i falë bizniset komplet, le të operojnë, se ashtu ashtu ka edhe komuna të tjera të cilat janë të liru në këto biznese prej taksave dhe janë tuj zhvillu.
Pasi është këtu vetëm për 2024 edhe unë propozoj me një vendim të veçantë që për vitin 2024t'i lirojmë këto biznese prej taksave.

Meqë nuk pati diskutime, tjera kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **"Për"** votuan 16 anëtar, 12 kundër, 1 abstenim.

**Mërgim Pirraku:** Po më vjen keq që po flas pasi u krye pika, mirëpo as nuk po du me ra në kundërshtim me kërkan, Na mujna me bo kërkesa populiste këtu, jo me i liru, jo kështu me i hater, edhe pse s'po du me konsideru që dikush po do me i hater me bizneset, mirëpo nuk po e kuptoni një diçka, shteti funksionon me taksa edhe na nëse jena kundër taksave, jena kundër shtetit, unë jam për një popull për bizneset të forta, apo jam më shumë për një shtet të fortë.
Ju kisha lutë, mos dal unë këtu tuj premtu njerëzit që na mujna me diskutu jo lirimin e taksave, kështu.
Unë jam për me i lehtësu çdo sen, mirëpo...Ju kisha lutë nëse veç me më dëgju pak unë këtu muj me ba edhe kërkesa hajde që krejt bizneseve po ia dhanë ka pesëdhjetë mijë euro, po ku me i marr na ato?
Nuk po e kuptoni që ato na i marrim prej taksave e din ti, e gëzojnë që po më bën pyetje, të lutna veç të dëgjojmë, a e din ti cilat janë efektet anësore nëse na i lirojna prej taksave të gjitha bizneset në Drenas, a e din?
Domethanë, a e din ti që nashta nesër na dojna për shembull me si subvencionu disa biznese dhe ja po s'kena fonde, ndena me i solucionu për shembull disa që i kena, i kena përkrahë për shembull për sëmundje ose për tjera, për tjera s'kena me pasë fonde domethanë nëse ti do të m'i përkrahë vetëm një ko kategori.
Une nuk i kam shikuar taksat, po jam i sigurt që Kosova i ka taksat ndoshta më të ulëta në rajon.
Shkon nëpër shtetet si Gjermani,Danimarkë, të gjithë paguajmë taksa ndoshta kah katërdhjetë për qind, qoftë në pagë, qoftë atje na po paguajmë na, për shembull,Unë vetë e kam biznesin, pagu nëntë për qind e paguaj, nëse për mu nuk është kurrgjë.
Nëse unë jam tu mendu si biznes, nëse për mu nuk është kurrgjë me pagu nëntë për qind, sepse fitoj mjaftueshëm.Nëse na tash nuk marrim taksa, nesër kena me u ngulfatë edhe s'kena mujt me përkrahë me kurrgjë edhe ashtu tani fillon me u me vdekë ekonomia.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,**
Do të thotë, ta shkojmë në pauzë një orë.

*Pas pauze:*

**Ramiz Lladrovci-Kryetari i Komunës:** Egzonë ta kam dhënë një përgjigje të pasaktë në raport financiar, kur kam thënë që janë pagu për pesë për qind të kontratës, nuk është e e vërtetë, është një raport i i

gjashtëmujorit, ose i tremujorit të kalum, ku u përfshi kjo shumë që e keni pas në raportin me njëzet e gjashtëtë katrit është pagu projekti i sheshit njëqind e pesëdhjetë mijë euro.
Pra, edhe një herë kërkoj falje, sepse kur thatë jonë tre se i bjen me kanë tremujorët e fundit, e disha që nuk ka një pagesë të tillë për atë çeshtje.
Pra, edhe një herë sqarim, njëqind e pesëdhjetë mijë euro që flitet janë pagu për shesh, është projekti i cili u pagua për shesh.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Xhevat Qorri.**
Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 20 anëtar, **(Për)** votuan 20 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Anita Kastrati.**
Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 20 anëtar, **(Për)** votuan 20 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Lirije Prenku.**
Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 20 anëtar, **(Për)** votuan 20 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Liridon Hasani.**
Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 20 anëtar, **(Për)** votuan 20 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjete të rendit të ditës: **11.Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Dorentina Shehu.**
Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 20 anëtar, **(Për)** votuan 20 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës: **12.Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Sabahate Gashi.**
Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 20 anëtar, **(Për)** votuan 20 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës: **13 . Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Argjira Gjinofci.**
Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 20 anëtar, **(Për)** votuan 20 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e katërmbëdhjetë të rendit të ditës: **14. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro**

**Biznese dhe Start-up në projektin e Viola Dibrani.**
Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 20 anëtar, **(Për)** votuan 20 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës: **15. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Valdrin Istogu.**
Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 20 anëtar, **(Për)** votuan 20 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës: **16. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Taulant Mziu.**
Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 20 anëtar, **(Për)** votuan 20 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e shtatëdhjetë të rendit të ditës: **17. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Rijon Ramadani.**
Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 20 anëtar, **(Për)** votuan 20 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e tetëmbëdhjetë të rendit të ditës: **18.Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Gentian Bujupi.**
Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 20 anëtar, **(Për)** votuan 20 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Egzona Tërdevci:** E vlerësoj praktikën që është nda me neve një raport i tillë i shfrytëzimit të subvencioneve. Po shpresoj që shpejt mund me pranu edhe për vitin dy mijë e njëzet e dy.
Ai që e kemi marrë është për vitin dy mijë e njëzet e një. Qka është shqetësuese që njera prej përfituesve jeton në gjermani kërkoj një shpjegim, a ka shku vetëm për vizite apo si?

**Kryesuesi** e ka evidentu drejtoresha dhe sqarojmë në pikën e të ndryshme.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e nëntëmbëdhjetë të rendit të ditës: **19. Propozim vendim për ndarjen e kapitalit themelor për NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A, Drenas.**
Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 21 anëtar, **(Për)** votuan 21 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e njëzet të rendit të ditës: **20. Të ndryshme**, Diskutim rreth "Flutura Akadami"

**Egzona Tërdevci:**
Si asambleistë dhe jo vetëm ne të Vetëvendosjes, por edhe kolegët nga subjektet tjera politike, kemi marrë vazhdimisht kërkesë nga shumë prindër të shqetësuar të Drenasit lidhur me ndërprerjen e punës së "Flutura Akademie"
Për ata të cilët mund të mos e dinë, "Flutura Akademie" ka vepruar në Drenas që nga shtatori i vitit dy mijë e

njëzet e një.
Dhe përgjatë kësaj kohe, sipas evidencës që ne kemi, aty janë shkolluar rreth një mijë e pesëdhjetë vajza e djem të ri të qytetit tonë.
Programet e veçanta të flutura në akademi si programim, robotikë, rrjeta kompjuterike, dizajn grafik, gjuhë angleze dhe gjuhë gjermane janë vetëm disa nga programet që kanë ndihmuar të rinjtë e qytetit tonë që të aftësohen ekstra asaj që u ofron shkolla fillore dhe e mesme dhe njëkohësisht të jenë të gatshëm të kyqen në tregun e punës, ku tashmë veç kemi informacion se disa prej tyre janë kyçur në punë në kompani të ndryshme në këto fusha, duke kontribuar kështu edhe në zhvillimin ekonomik të qytetit tonë.
Unë kam kërkuar qasje publik në dokumenta publike lidhur me komunikimin në Komunë të "Flutura Akademi për çështjen e objektit publik që kishin në shfrytëzim kjo akademi.
Nën arsyetimin që këto korrespondenca nuk prodhojnë material zyrtar për komunikim të brendshëm, e kam pranu vetëm kërkesën e protokolluar nga kjo akademi lidhur me çështjen e objektit të datës shtatëmbëdhjetë, tetë, dy mijë e njëzet e tre dhe kontratën e nënshkruar, të nënshkruar nga viti 2022, Nga ajo që kemi marrë si informacion nga Këshilli i Prindërve të "Flutura Akademi" komunikimi për çështjen e objektit mes "fluturës" dhe komunës ka filluar shumë më herët sesa kërkesa që është protokolluar zyrtarisht.
Gjatë kësaj kohe ekzekutivi është kontaktuar disa herë me shkrim nga "Flutura Akademi" për çështjen e objektit.
Për ata që mund të mos e kenë informacionin, "Flutura Akademi" njëjtë si bizneset si motra akreditohet nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve për programet e ofruara dhe një nga kriteret për të përfituar akreditimin, duke i ditur këto numrin e nxënësve që do t'i humbin këto mundësi trajnimi është edhe faktin që trajnimet e ofruara, nga trajnimet e ofruara janë pronësuar tridhjetë nxënës si dhe kanë qenë pesëmbëdhjetë veta staf të gjithë të rinj e të reja tejet profesionist të qytetit tonë.
Komuna e Drenasit ka bërë një gabim shumë të madh me pamundësimin e vazhdimit të aktivitetit për akademi, duke ia mundësuar kështu vazhdimin e objektit.
Nga kontakti që kemi pasur me prindër arsyetimi juaj ka qenë se ata vetë nuk kanë dashur të qëndrojnë në objekt, por ju lutem zotëri Lladrovci na thoni se cili institucion serioz dëshiron të qëndrojë në një objekt për të cilin nuk ka leje.
Duke u bazuar edhe në kontratën që më është përcjellë përmes e-mailit nga drejtoresha Demaj, kontrata me flutura akademie është nënshkruar me datë pesë gusht dy mijë e njëzet e tre.
Në një situatën më të mirë, mos reagimi juaj mund të ia aturbohet neglizhencës të madhe që keni ndaj përgjegjësisë publike që ju është dhënë nga qytetarët e Drenasit.
Në vend se të mbështesim një akademi të tillë, e cila ka shkolluar aq shumë të rinjtë e reja të qytetit tonë, ta pengojmë të njëjtën, duke mos i dhënë objektin për veprim, e t'i shkaktojmë shpenzime shtesë me ndërrim të lokacionit, nuk është aspak në linjë me atë që ju proklamoni se vazhdimisht se jeni për zhvillim ekonomik të qytetit, e se jeni mbështetës të rinisë sonë.
T'ua humbasësh mijërat të rinjve mundësinë për t'i ndjekur programet e përmendura për zhvillim profesional pa pagesë e te cilat nuk kushtojnë pak nga ajo që dimë nga tregu, Duke u thirrë në atë që kanë kërkuar prindërit e fëmijëve që vijojnë shkollimin atje, ne ju lusim që të reflektoni dhe ta trajtoni siç duhet bashkëpunimin me këtë Akademi, si një dhe kolegët jemi dëshmitarë se sa herë për mos punën tuaj në sektorin e rinisë jeni lavdëruar me punën që ka ba "Flutura Akademi"

**Ramiz Lladrovci Kryetari i Komunës:** të falënderoj për fjalimi, në qoftë se është krejt kështu qysh po thua në vitin 2021 Flutra Akademi, për të cilin subjekti ju, e që më vjen kjo që nuk është këtu personi që më ka kritiku në këtë Kuvend për dhënien e objektit Flutra Akademi, sikur unë jua kam marrë drejtën rinisë me shfrytëzu atë objekt.
E dyta, është vendim i jemi.
Kur e kam dhanë, sepse rregullorja që e ka votu Asambleja, ma ka leju me i dhanë hapësira deri një vjet pa qira, me ma të mermi në qëllim me i ushtru, me i trajnu e me i certifiku fëmijët tanë në shkresën e Flutra Akademie, thotë: me na dhanë me qira për tri vjet, me qëllim që na mu akreditu që certifikatat ose vërtetimat me qenë të vlefshëm për fëmijët tanë.
Unë e kam shqyrtu atë mundësi kohë të gjatë dhe i kam pas në dispozicion, edhe të paktën edhe njëmbëdhjetë ditë nëse nuk gaboj, për me ju dhanë përgjigje.

Asnjë ligj në fuqi në Kosovë nuk ma jep të drejtën m'i dhanë një OJQ-je objekt për tri vjet në Shfrytëzim, ma jep të drejtën ma pak se një vjet që i bjen njëmbëdhjetë muaj e njëzet e nëntë ditë po e zëmë ose tridhjetë, po pa ma pak se një vjet.
Edhe unë e kam shqyrtu e kam trajtu.
Nëse "Flutra Akademi" ka përdorë objektet e mia, kur flas të miat, po flas të komunës, sepse i përfaqësoj krejt, edhe certifikatat e tyre janë jovalide, sepse nuk janë certifikum, atëherë më vjen shumë keq që unë kam bo gabim kur ia kam dhënë 2021 atë objekt.
Meqenëse ju po kërkoni ose po keni dhimbje, unë këtu jam edhe me marr mendimin e juaj nganjëherë Prandaj, propozimet e juve i marr të mirëqena, po me majtë ligjërata mësim dikush për diçka që e kam bo të mirë, po që pala tjetër nuk i ka arritë rezultatet E duhura na e dimë sa ka trajnu dhe në kohën e pandemisë e dimë numrin e saktë dhe e dimë certifikatat sa janë të vlefshme tashmë.
Unë as nuk kam pas të drejtë dhe as nuk kam të drejtë me i dhanë kurrkujt objekt për tri vjet, me qëllimin e vetëm që ata mu licencu prej x institucionit atje për me vlejt certifikatat e tyre.
Faleminderit!

**Egzona Tërdevci:** Prej asaj që e thatë nuk patëm naj argument të vlefshëm sepse nuk ia keni vazhdu kontratën, jo për tri vjet, por ju keni mujt me ofru mundësinë e bashkëpunimit për një vit edhe nuk është shumë arsyeja që keni pas ende kohë kur shkresa është dorëzu me shtatëmbëdhjetë tetin e kontrata ka skadu me pesë tetit, si ithtar i ligjit që e mbroni ligjin, e proklamoni vazhdimisht që punoni me ligjin, ju e keni pas evidencën që kontrata e tij operatori i skadon me datën pes tetit edhe deri atëherë dasht me marr ndonjë përgjigje.
Ë thatë që është dashtë me ma dhanë një falënderim, po besoj që ju kur e keni marrë detyrën si kryetar i komunës e keni marrë për me i shërby qytetarëve pa pritë falënderime në këmbim.
Po, por për dijeninë tuaj, me datën një korrik, kur kanë diplomuar qindra-tri nga flutra në Akademi, juve ju ka përfaqësu drejtori Muhamet Gjoka dhe nuk po besoj që ka shumë dallim si me marrë jo falënderimin si me marr ju si drejtoruai juaj është e njejta, tha që diplomat që i paskan ndarë këta certifikatat nuk janë të vlefshme.
I nderuar zotëri Lladrovci, në fushën e ICT-së, për ata që e kuptojnë, në fushën e teknologjisë nuk është që duhet shumë dëshmia, mjafton me pa bizneset që dinë me punu dhe të ofrohet mundësi punësimi.
janë dhënë informata të verifikueshme, mundesh me bisedu me prindër e të rinjve që kanë marrë trajnime në "Flutura akademi" për mua si asambleiste, si qytetare, po edhe si e re, Drenasit prapë nuk ka arsyeshmëri ajo që e keni ba ju.

**Enkela Dema, Drejtoreshë për Kulturë Rini dhe Sport:**
Rreth shkresës, që po e përmend zonja Tërdevci, kërkesa zyrtare që na ka ardh përmes protokollit është më datën shtatëmbëdhjetë gusht, ashtu qysh e keni pa dhe e kam përcjellë në e-mail, kur keni kërku dokumenta zyrtare, qasje në dokumente zyrtare.
Keni kërku edhe do korrespondencat që nuk janë dokument zyrtar dhe këtë desha ta sqaroj se e përmende më herët, sipas Ligjit për qasje në dokumente publike.
Pavarësisht asaj, me datën 17 gusht neve e kemi marrë shkresën zyrtare nga Flutra Akademi dhe me datën 18 shtator ende pa i bo aktualisht fikse dhe vetë ditë ka pas afat me u kthy ligjor shkresa për kontratën e "Flutra Akademisë"
Kur thatë se me datën 5 ka dalë kontrata, Me sa e dini edhe ju, punë mjaftueshëm ka nëpër drejtori që me i përcjellë të gjitha kontratat dhe me i u ne gati përpara për atë punë secila shoqata, apo secila akademi që ka marrë objekt nga komuna, e ka për detyrë të bëjë kërkesën ligjore brenda afateve që ajo korrespondon.
E në faktin tjetër, nëse kisha mujt me u lidh dhe me datat të mëhershme që janë bo shkresat e Flutra Akademisë, kanë qenë kur Flutra Akademi e ka pas respektivisht kontratën e lidhur dhe kontratë aktive, mbi të cilën ne nuk mundemi me bo kontratë mbi kontratë.
Nëse dikush prej juve e njihni ligjin, po besoj që këtë mundeni me ditë shumë ma mirë.
Në anën tjetër, kur ky po ky Kuvend ka kundërshtu për me japë Flutrën Akademi objektin për t'i zhvillu këto aktivitete edhe në nenin shtatëmbëdhjetë thuhet qartë dhe po kësaj rregulloreje që ju e keni votuar është Kuvendi i barabartë të drejtën ia kalon kryetarit që të bëjë lirimin nga pagesa e çdo tarife që është e përcaktu

përmes kësaj rregulloreje, ku ia ju ia keni kaluar kryetarit dhe kryetari për të mirën e këtyre studentëve po ashtu i ka liru të gjithë nga pagesa, sepse qiraja për dhënien e lokalit afarist komercial fillon nga katër euro për metër katror.
Nëse ka diçka tjetër që duhet me e bëtë qartë rreth flutura e akademisë, atëherë ju lutem për pyetje, muni me zhduk.

**Egzona Tërdevci:** Faleminderit edhe për përgjigjen që e kam marrë përmes emailit për qasje ne dokumente publike, po nuk po e kuptoj çka është problem nëse e njëjta kërkesë iu ka adresuar përmes emailit prej flutur në Akademi.
Nëse ju jeni këtu me e drejtu dikasterin për rini, kulturë dhe sport, edhe njiheni një institucion që ju ofron të gjitha këto mundësi për të rinjë, qysh nuk e keni gjetur një kohë prej kohës tuaj të vlefshme me edhe prapë qëndroj te ajo, se ligjërisht nëse një ë operatorit i ka skadu kontrata me pese tetit, ju si Komunë keni leju që me shfrytëzu paligjshëm, nëse e quajmë shfrytëzim, se ata sa dje edhe kanë ndërprerë trajnimet për këtë kohë, kjo nuk ju jep arsyetim që keni pritë deri në tri ditë e fundit me ua kthy kërkesën.
edhe qysh do qofshin gabimet teknike që kanë mund mu ba, asgjë nuk e arsyeton prapë ë faktin që ju e keni ndërprerë punën e një institucioni që ka kontribu në zhvillim të qytetit edhe që i ka aftësu minimit të ri të qytetit.
Po hajde, po e zëmë që edhe Flutra paska kërku për tri vjet, ju po i bëni këto propozime afatgjatë, keni mujt me pru në Kuvend Komunal edhe kur po thoni ka kundërshtu i njëjti Kuvend, bëhet fjalë për një legjislaturë tjetër, nuk behet fjale per legjistraturen tonë për me pas të qartë.

**Enkela Dema, Drejtoreshë për Kulturë Rini dhe Sport:** thatë që me datën pesë i ka kalu afati dhe neve e kemi pranu emailin përmes flutura e akademisë për zgjatjen e këtij afati, siç e dini edhe vetë e nëse mundeni me i kontrollu kontratat që bëhen në bazë të ligjit të Republikës së Kosovës, e mandej i keni nenet e dane dhe të caktune që çdo kërkesë për kontrata sipër qiradhënie të afariste objekteve afariste komerciale, po ashtu edhe të pronave e të gjitha llojet e këtyre dhënieve të qirasë janë me kërkesa zyrtare.
Po ashtu, unë edhe shpjegova edhe më herët edhe ta kam shpjegu edhe në email, ku e kam përcjellë edhe dokumentin që me datën shtatëmbëdhjetë gusht unë vetëm atë ditë kam pranu kërkesë zyrtare për vazhdimin e kontratës edhe për të për të mos u zgjatur, juve keni po ashtu ku e e ceka që korrespondencat nuk prodhojnë dokument zyrtar, atëherë vlen edhe kjo që kur e email ka ardhë për vazhdimin e kontratës, ajo korrespondencë nuk është dokument zyrtar.

**Egzona Tërdevci:**Kryesues, Nuk po kuptoj çka ka shqetësim nëse kish ardhë në Kuvend Komunal edhe kishim aprovu një tarifë shumë të ulët për ta.
Nuk besoj që as për ata do ishte problem, nëse sot ata dalin edhe për shkak që ju i keni i keni nxjerrë, ta quajmë prej objektit se si ua keni vazhdu kontratën, nëse dalin paguajnë privat, ishin kanë të gatshëm me pagu edhe një tarifë të ulët që ia kish përcaktu Komuna.
Po mu çka po më shqetëson si Asambleiste, se është që nëse operatorët ekonomik që ne ia japim pronat nuk paskan vullnet me shkru një kërkesë zyrtare për me vazhdu me shfrytëzu pronën, na si Komunë po i mshelshim sytë dhe po i lashim me i shfrytëzu deri pa kufi. Kjo është tepër shumë për shqetësim.
Nëse duhet patjetër me pritë një kërkesë ë prej operatorit, e dimë që jo të gjithë janë të përgjegjshëm, kjo qenka për shqetësim Komuna këtu veç po po rrika po bëjka se hir.

**Ramiz Lladrovci Kryetari i Komunës:**Nëse ti nuk i ke e-emailat, ose komunikimin që e ke kërku, të pakten Hamiti ka thanë që i ke ne e-mailat.
Zyrtarja, në të kërkon falje publike që e kam bo për shkak e emocioneve dhe pagës të madhe, unë i kam i gatshëm me ia dhanë objektin edhe për njëmbëdhjetë muaj e njëzet e nëntë ditë shfrytëzim.
Faleminderit!

**Egzona Tërdevci:** E para, nuk e di kujt po i referohesh me e-mail emocional dhe nuk e di kush po dashka me kërku falje, por nëse një kryetar Komune bjen në këtë nivel që për me e mbushë egon e vet me një kërkim falje prej kujtdo qoftë personi që e pret një kërkim falje edhe në kurriz të kësaj, i lë një mijë e sot

mijë pa shkollim joformal që e plotëson shkollimin që e morri në shkollë, shumë keq zoti Lladrovci! Kam këndërru që jeni pak më i pjekun se kaq.

**Ramiz Lladrovci Kryetari i Komunës:** Punën e mirë duhet me konkretizu edhe me një dokument një fëmijë me që e ka hupë kohën tre katër vjet dy vjet atje mu pajis me një dokument legjitimi cili i pranohet dikë.
Kjo i bien që më kanë mashtru mua.
Faleminderit!

**Hamit Haxhiu:** Kryetar, masi po diskutohet dhe është për diskutim Flutra Akademi, para se me mbyllë di këtë Flutrën Akademi, a e ke mendu zgjidhjen e këtyre një mijë e pesëdhjetë nxënësve?
Çfarë zgjidhje do me bo?
Kur e dimë se disa komuna e kanë liru edhe objektin e shkollës nje një kat të objektit të shkollës e vetëm për me ju bo zgjidhje këtyre nxënësve, a ke mendu çfarë zgjidhje me ju bo këtyre një mijë e pesëdhjetë nxënësve?
unë punoj ti e di shumë një në shkollë të mesme, shumë nxënës kem që janë trajnu ne Flutur në Akademi dhe kanë ba zgjidhje domethanë sot punojnë në drejtimet e tyre të cilët i kane ndjek këto kurse apo trajnime në "Flutura Akadami"

**Ramiz Lladrovci Kryetari i Komunës:**
Kur une i kam ftu ata dhe ja kam bo zgjidhjen, ata më kanë thënë si e ke bo për njerëzit tuaj, për kolegët tuaj, pa e ditë si vijnë njerëzit e tina e tyre me punu.
Unë po them e kam bo për të rinjtë, Edhe kam përgatitë atë objekt të cilin e kanë shfrytëzu njëri kush.
Kushdo me i qu fëmijën në trajnim e ka mundësinë me i qu dhe me bë një pagesë të vogël për trajnim, atë pagesë s'e marrim unë e marrin ata.
Në qoftë se ata janë aq të mirë, ne të na thonë sa e paguajnë qiranë një objekte na po e diskutojmë edhe ata prapë në të vazhdojnë një mijë e pesëdhjetë mijë me mbajtë ose edhe më shumë me mbajtë në mësim po a e dini që ajo një mijë e pesëdhjetë mijë ti në një objekt të tillë.

**Mehedin Salihu:**
E drejtorish, unë në kontekst i morëm edhe disa pyetje, por mua po më intereson ma konkret, a janë shterë tana mundësitë e bashkëpunimit me Flutur Akademi, a u met në një rrugë e bashkëpunimit, a mujmë me ndryshu diçka apo jo?

**Enkela Dema, Drejtoreshë për Kulturë Rini dhe Sport:** që neve ju kemi afruar mundësinë flutura e akademisë, po ky legjislativ jua ka afruar mundësinë atyre për me me i bo këto aktivitete dhe janë po vetë flutura akademi ata të cilët kanë kërku tërheqjen prej bashkëpunimit, në mungesë të përgjigjes brenda afatit ligjor, gjo që na e kemi pas edhe dhjetë ditë për diskutim, ndoshta gjatë atij diskutimi kemi mujt me marrë masa për ndonjë tjetër objekt, sepse si qysh e di edhe ti vetë, ne kemi shumë OJQ e organizata të rinjve që kanë ba kërkesa të vazhdueshme për me qenë në qendrën e rinisë, edhe nuk kemi mujt me ia mundësu, për shkak se e kemi lëshu për flutura Akademinë, po, pa e marrë parasysh të gjithë vëllimin e kërkesave që i kemi për të gjithë këtyre grupeve rinore, të cilët nuk kanë ku me i zhvillu tash e tutje aktivitetet e tyre, sepse planin që neve e kemi ba për për me pas sallat e veta, apo ky Kuvend nuk e ka kalu, atëherë ne jemi shumë të mangët në hapësirat që i kemi për të rinjtë tanë.

**Mehedin Salihu:** Nuk po përputhet e vërteta, ta kisha shprehje ashtu kuptimisht, se Flutra Akademi nuk po thotë ngjashëm qysh po thoni ju.
Ata janë të anku që ju i keni largu, jua keni ndërpre bashkëpunimin.

**Enkela Dema, Drejtoreshë për Kulturë Rini dhe Sport:** që m'u kon kjo art, ndoshta ju nuk i keni pa edhe emailat, po për këtë emailin e fundit muj me marrë përgjegjësi personale për me ja u bo publik, emailin ku Flutra Akademi është tërhequr nga bashkëpunimi me Komunën e Drenasit dhe në këtë rast neve nuk kemi se

çfarë përgjigje tjetër me i japë dikujt që don me u largu nga objekti që neve e kemi dhënë në shfrytëzim.

**Hamit Haxhiu:** Ju e keni marrë email-in e fundit drejtorishë, para teje kanë edhe katër-pesë email-a duke iu referuar Drejtorisë së Arsimit, ka pas email prej fluturës, ka pas zyra e kryetarit, ju keni pritë momentin e fundit dhe e vetmja ju jeni, domethënë pas katër-pesë e-mailave zyrtare që ju kanë kontaktu juve, ti e ke kthy një e-mail zyrtare.
Domethënë as nuk e ka kthy zyra e e kryetarit, as Drejtoria e Arsimit.
Ju e keni lënë deri në momentet e fundit.
Unë po pajtoj se jam unë me kanë brenda afatit ligjor, po ka pas kohë boll edhe me ardhë edhe me u trajtu kjo tejmë sikurse tash qysh po trajtohet edhe me pa mundësinë me pas mundësinë me shfrytëzu a mujmë apo nuk mujmë.
Po sido që të jetë, s'është me rëndësi a është jemi, po këtu mbrojmë interesat e të atyre fëmijëve.
Unë thashë çka don me ju ba zgjidhje?
E ke mendu ti me ju ba zgjidhje këtyre nxënësve të cilët janë kanë të regjistrum në Flutra Akademie që ua ke ndërpre kursin ose trajnimin?

**Ramiz Lladrovci Kryetari i Komunës:** Unë obligim me ligj e kam arsimin e mesëm dhe te ulet dhe fëmijët në çerdhe, kurse trajnimet janë shtesë, nuk kam asnjë obligim me ligj.

**Egzona Tërdevci:** Unë e kam me ngrit një një çështje, po paraprakisht dua shkurt me ju kundërpërgjigj, jo për flutrën, por për diçka që tha drejtoresha Demaj, edhe që jeni duke përdorë vazhdimisht si argument, si ekzekutiv.
Sa herë po dështon diçka, po thoni që s'ka hapësirë pse ka pas mu bo objekti i vjetër i komunës një objekt gjiganti sipas juve.
Krejt çka ka pas me u ba atë në shërbim të publikut në kanë amfiteatër edhe biblioteka?
Mosni bre se njerëzit lexojnë e i ngojnë senet dhe nuk ka pas me u ba hapësira për të ri.
Është çështja e projektit, është zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit "Xhevë e Fehmi Lladrovci"
Unë e kam përcjellë prej kur është shpallë tenderi për këtë projekt, e kam përcjellë që lënda ka shku në OSHP edhe qaq sa ka informacione publikisht, OSHP-ja nuk ka dhënë vendim.
Megjithëse OSHP-ja nuk ka dhënë vendim, Komuna e Drenasit si autoritet kontraktues e ka dhënë tenderin, që nuk është në rregull me ligjin.
Nëse ka një vendim të OSHP-së, e cili na nuk e kemi, ju lutem na jepni vendimin dhe jemi në rregull.

**Ramiz Lladrovci Kryetari i Komunës:** merre përgjigjen në OSHP, unë s'kam përgjigje, unë kam zbatuar ligjet dhe kam zbatuar afaten.
Sa i përket asaj se çka ka pas mu bo te komuna e vjetër, shumë ka pas mu bo pesë mijë e gjashtëqind metra objekte për nevoja të komunës, këtu përfshin sallë, amfiteatra, zyra për partitë politike, për grupet parlamentare, biblioteka e tjera e tjera e tjera. Pra, ka qenë një dam kolosal që iu ka ba komunës veç për inate personale të disa asambleistrave, se kurrë s'e kam pritë votën mbi teje as aty.

**Mërgim Pirraku:** Nëse më lejo të kisha vazhdu me një pyetje, e kam për Muhamet Gjokën, për drejtorin, drejtorin e Arsimit.
Disa prindër, pra qytetarë të Drenasit na kanë shkrujt që në disa shkolla janë humb disa orë për shkak, jo për shkak për zënë profesori ka qenë smutë ose diçka me arsye, por nuk kane pas profesor.
Edhe unë nuk po e marr këtën si të mirëqenë, pra nuk po e marr si të besueshme, meqë nuk është zyrtare.
po du me ta dha mundësinë me na tregu a është e vërtetë dhe nëse është e vërtetë, ku janë ato vende dhe pse?
Në fshatin Krajkovë, ku e kemi informatën, është e vërtetë nuk e di, Nuk i kam marrë të mirëqena.
Pra, nuk i kam marrë të besueshme.
Nuk i kam marrë zyrtare.
Edhe këtu jam për me ngritë shqetësimin e tyre dhe njëjtën kohë me japë hapësirë drejtorit me na me na sqaru.
Na e dimë që në të kalunën kena pasë humbje.

Domethënë kemi pasë në fshatin tem, fshatin Sankoc ka pas të humbura për shkak që është vonu konkursi Ju kisha lutë mos të na ndodhë, veç një rast shumë shumë i veçantë kur të kemi raste të vdekjes ose ndonjë diçka se humbja e orëve mesimore me mua është diçka e tmerrshme.

**Muhamet Gjoka-Drejtor i Arsimit:** ju informoj se konkursi për të gjitha vendet e lira që i kemi pas informatat në bazë të raporteve të drejtorëve edhe në bazë të listave të mësimdhënësve që dalin në pension dhe në bazë të analizës nëse është konstatu që duhet të zëvendësohet, sepse orët nuk mund të shpërndahen, atëherë e kemi zhvillu konkursin qysh në qershor konkursin e rregullt për vendet e lira.
do të thotë konkursi është hap në qershor, por për shkak se Rregullorja e re legjislacioni e kërkon që konkursi kur hapet me me qëndru një muaj si informim, pastaj janë pesëmbëdhjetë ditë për aplikim, kjo e ka marrë një kohë rreth dy muaj, ku është përzgjedhë stafi për mësimdhënie.
Kjo nuk do të thotë se gjatë muajve me rastin e fillimit të vitit shkollor nuk ka lëvizje, procesi mësimor është shumë dinamik.
Unë pajtohna me juve që thatë që ë duhet me kërku edhe për mësimdhënësve me qenë më të përgjegjshëm që nëse ata planifikojnë me me u tërhjek për ndonjë arsye ose me me lëvizë qoftë jashtë vendit apo për arsye personale, me na njoftu me kohë, sepse merr kohë procedura për zëvendësim.
Shto kësaj faktin që në disa profile, sikur që e përmendët rastin në Krajkovë, ku kemi mungesë të një mësimdhënësi të matematikës, ku mësimdhënësja që ka qenë aty, ka qenë pushim mjekësor.
Për raste të pushimeve mjekësore, ne e kemi mendu nje zgjidhje me i angazhuar mësimdhënësit prej listës pritëse, por profili Lista pritëse me ligj thotë që duhet të kenë përgatitjen adekuate mësimdhënësit, në mënyrë që mund të angazhohen, të jesin në listë pritëse dhe të angazhohen sipas nevojës.
Në këtë rast, në matematikë, fatkeqësisht nuk kemi kuadër me dyqind e katërdhjetë kredi adekuatë, të cilët i kemi në listën pritëse.
Kështu që ne e kemi hapë konkursin me të marrën me marrjen e informatës, sepse mësimdhënësja, përveçse ka qenë në pushim mjekësor, ka kërku edhe pushim pa pagesë për trajtim të fëmijëve jashtë vendit.
Kështu që konkursi është në procedurë dhe po besoj që shumë shpejt ka me u kry procedura dhe ka me angazhu mësimdhënësit në fjalë.

**Mërgim Pirraku:** Po më fal, s'pe kuptoj qysh po e thua nuk kena pas mësimdhënës adekuat në matematikë, kur unë e njoh dikë.
Unë e njoh dikë dhe qysh po thu, a po qysh ka mujt me konkurru i nderum kurrë s'ka hapë konkurs.
Unë nëse nuk e kuptova, se ndoshta nuk të kuptova veç të thënë Krajkovë, janë orë që nuk janë plotësu edhe na nuk kena mujt me gjetë profesor adekuat, a ke hapë konkurs unë s'po di.

**Muhamet Gjoka-Drejtor i Arsimit:** I nderum, konkursi është i hapur.
Dhe, unë e di që e ke familjar.

**Ramiz Lladrovci Kryetari i Komunës**: ata që i kemi pas listë të pritjes, nuk kanë qenë adekuat.
Ligji thotë me qenë adekuat adekuat.
Nëse kemi pas ne një listë të pritjes, qoftë për para shkollore, ose për mësim klasor, ose për biologji, nuk kemi pas për matematikë.
Në këtë aspekt e sqaroj.
Ne humbim me mësimit.
E rëndësishme është drejtorat me raportu humbjen e orëve të mësimit.
Hala më keq na kena pas që s'ka humbur mësimit edhe dikur drejtori ia ka pagu atij edhe unë jam i detyruar që me e qu Komision Disiplinore për veprime tjera.

**Mehedin Salihu:** I kam disa pyetje:
Pyeti z. Gllareva, e përgëzoj për punë të mëdhaja që po bon, por mirë edhe ndonjë punë të vogël me kry, një grop para Furrës-Pashtriku, kërkoj me e rregullu!
Edhe nën dy për drejtoreshën e Shëndetësisë e kam një pyetje, është shqetësuese numri i njerëzve që është në

rritje me kancer.
Ata kanë nevojë për ndihmë, konkretisht herën e fundit ka bërë kërkesa E di që e ka bo kërkesën por kërkesa e fundit që e ka bërë Mehmet Bylykbashi veteran i UÇK-së a ka ndonjë lëvizje në këtë drejtim a mundemi të bëjmë diçka për këtë kategori.

**Ramiz Lladrovci Kryetari i Komunës:** për gropa nëse janë projekte që i kena bo na si kanë bo punimet mirë, janë të obligun kompanitë, por nuk kemi të drejtë me investu
Për çka ke bërë që subvencione, e dini që në dy mbledhje më herët kena thënë që i kemi harxhu buxhetin, po unë sot kur kam bo disa herë me i sjell Propozim-ndryshim të subvencioneve m'i ka lutur Shëndetësia, na duhet me e bo një propozim ndryshim, me ndryshu prej një kodi në kod tjetër me pru edhe ai na merr një muj ditë a vetë për me mujt me i ndimu këto raste domethanë që janë shumë shumë të nevojshme.

**Egzona Tërdevci:** nuk është më tu kundër përgjigjë as kurrgjë, veç me dhanë informacion për rastin e Mehmet Bylykbashi, sipas informacioneve që i kam përmes një familjare, ai tashmë i ka siguruar mjetet e nevojshme për trajtim, po mos e merr informacionin që për të qenë të sigurt, por kjo është informacioni që unë e kam përmes një lidhje familjare.
Domethanë, sot jonë është veç t'u pritë kështu proceduralisht me u kry procedura që me rri me shku me kërku shërimin jashtë vendit.

**Ramiz Lladrovci Kryetari i Komunës:** për trajtim ka obligim Ministria e Shëndetësisë me ja u siguru, që ta keni të qartë.
Për trajtim tani domethanë në afate të ndryshme ata kur s'kanë buxhet të vetin, na është mirë me ju ni mua, edhe për qit send po provojnë me ju ni mua domethanë qit temë, obligim s'kemi.
por na provoj na minimu që drejt ai është obligim i qeverisë, i Ministrisë së Shëndetësisë.
Ka komision për atë punë edhe i alokon mjetet, qoftë përjashtë, qoftë përbrenda.
Faleminderit!

**Valentina Leku:**unë po e do po e sjell një kërkesë bashkëfshatarëve të mi të fshatit Llapushnik, të cilët kërkojnë ndriçimin e rrugëve, po ashtu rregullimin e kanalizimeve, pse këto kena marrë përgjigje disa herë apo kanalizimi i cili po paraqet problem të madh tash në kohën e të reshurnave, që është kanalizimi i teknallimin në lagjen e "Gashi"
Këtë pjesë të rrugës e dimë që komuna nuk mund të intervenojë pasi konsiderohet pronë e Ministrisë së Infrastrukturës, por banorët aty janë të komunës tonë, edhe nxënësit këmbësorët janë të rrezikunë, sepse nënkalimi bëhet i pakalueshëm dhe fatkeqësisht e ka e shfrytëzojnë rrugën mbi rrugën magjistrale.
Kërkesa e këtyre banorëve është a mundet komuna jonë të ndikojë te kjo ministri për rregullim e kësaj çështjeje ose a i lejonin fshatarët aty të rregullojnë vetë këtë rrugë, të cilët vitin e kaluar veç kanë fillu me punu, po ju ka ndalu puna prej policëve sepse s'kanë marrë leje.
Po ashtu, e komi një pyetje për drejtorin e arsimit.
Tash është koha e vlerësimeve të nxënëseve, ndërkohë kemi probleme teknike me fotokopjet, me printerët.
Edhe arsimtarët duhet me i printu vetë testet, planet, aktivitetet edhe a ka mundësi që ky problem teknik me u rregullu dhe kur?

**Ramiz Lladrovci Kryetari i Komunës:** ndriçimi i rrugëve, jemi duke e zhvillu projektin aty ku ka shtylla të betonit.
Kanalizimi, kur ka problem, na i shkruajmë Ministrisë së Infrastrukturës ose ministrisë përkatëse edhe ata duhet me na dhanë një zgjidhje, edhe po e presim atë zgjidhje.
Nënkalimet, jo veç ato që i ke na bo na për me lehtësua jetën e banorëve, ku jeni dhe ju, po edhe nënkalimet tjera, edhe ai që i ka bo Qeveria, në hyrje të Arllatit, të bëhet edhe ma i pa tejkalueshëm.
Por jemi mundua me zgjidhë atë problem me kalu edhe në Llapushnik pjesën tjetër me kalu rrugën, që edhe ata mos me shkume bo rrugë tepër edhe me rreziku me hidh direkt nën urë edhe me kalu në dy anët, pos unë kam leju fshatarët, na s'kena mujt me shpallë interes me ia marr, edhe i zgjidh edhe problemi i ujit, se aty kur të heqësh dheun, masandej shkon ujit nuk ndalet atë.

Për për printera kemi problem ne në komunë, kanë shkolla, kanë krejt.
Kompania nivel Qendror e ka lidhë është kontraktuesi edhe na disa herë e kemi dergu me ia shkëput kontratat, po edhe shkëputjen e kontratave me automatizëm nuk mund tabjeme. ë sepse e paralizojmë krejt institucionin edhe të komunës edhe institucionet tjera.
E kam menu me me me bo projekte, me zhvillu projekte që me pas çdo institucion printerin e vet edhe ë nuk na lejojnë.

**Labinot Halilaj:** Unë vetëm dy fjale pata për ish-bashkëpartiakun të, unë nuk e di në cilën partë ti ke kalu te zoti Lulla Drozës, unë në PDK jam kohë kur ti ke ba aktivitete edhe në subjekte të tjera.
Unë jam pranë në PDK edhe kur ia ardh ti në Partinë Demokratike, kur po ta shiko Kabinetin tënd i shoh krejt ngjyra politike të Komunës së Drenasit, po veç atë ngjyrën e Partisë Demokratike, e shoh më së pakti.
Nëse po pretendon atë që ti më ke përjashtu, unë po ta them edhe një gjë që nuk na jenë Parti Demokratike, Partia Demokratike ka organe dhe s'mundet me më përjashtu askush,
Por, nëse ti ke kalu naj subjekt tjetër, atëherë unë PDK jam, kush i mujmeve që po vazhdojmë me qenë bashkëpartiakë, por me qëndrime të ndryshme.

**Ramiz Lladrovci Kryetari i Komunës:** kur ta lexosh statutin, rregulloren, kodin disiplinor, e gjen veten.
Unë të respektoj, sepse jeta jonë është më e madhe se jeta partiake.
Për dijeni tanë jam themelues i PDK-së.
Faleminderit!

**Hamit Kastrati**: Unë kam një pyetje për drejtoreshin Lumen, kur do të rihapet AMF-ja në fshatin e Nekoc, tash e tri katër ditë që është i mbyllur nga kushtet jo të mira të higjienës. Kemi kërkesë nga qytetaret.

**Lumnije Krapi- Drejtoreshë e shëndetësisë**, Atëherë sa për informacion e të gjithëve dhe qytetarëve që po po na dëgjojnë edhe bashkëfshataret të fshatit Nekoc jeni në dijoni që ambulanta ka qenë në renovim prej Fondit Eficient, mirëpo pas përfundimit të renovimit ne kemi qenë i kemi pas informatat se ka mungesë të ujit për shkak që kompania i ka dëmto gypat  kështu që kemi qenë në procedurat e eliminimit të këtij problemit  Hamit në orën 9:19 min  drejtori i QKMF-së, së bashku me ekipin, kanë qenë atje me me evitu problemet.
Në orën dymbëdhjetë e njëzet janë ardhur inspektorët, të njëjtën ditë e kanë mbyllë.
E kështu veç dashta me ë mos sqaru që brenda një muje gjys tri herë i kemi pasur inspektorët prej Ministrisë së Shëndetësisë.

**Gani Krasniqi:**  Desha vetëm ta sqaroj për Mehmet Bylykbashi, ku dihet gjendja e tij shëndetësore shumë e randë. Është e vërtetë që kanë dalë kanë grumbullu mjete.
Mjetet janë grumbullu diku trembëdhjetë mijë e katërqind euro deri tash, ndërsa operacioni i tij na kushton mbi tetëdhjetë mijë euro.
Ju kisha lut të gjithë ata, të cilët edhe qytetarët e Drenasit edhe kushdo që na dëgjon ta kem gatishmërinë që t'i ndihmojmë, për shkak të gjendjes shëndetësore që e ka shumë të rend, edhe familja nuk ka mundësi t'i mbulon gjithë ato shpenzime.

**Hamit Haxhiu:**  me drejtoreshën e Shëndetësisë që tha vetëm për ujë, aty në bazë të Auvit që e ka dhanë, ka thënë edhe për arsye të mykut edhe për arsye të gypave të ujit, nuk është arsye vetëm me vetëm me ujit ajoqë është mbyll ambulanta në Nekovc.
Sa e kam lexu, në deklaratën e Auvit që ka përfundu për arsye të mbylljes së ë qendrës mjekësisë familjare në Nekovc, atëherë thuhet dhe për disa vërejtje tjera, nuk është pyetje vetëm uji.
A është me tendencë a pa tendencë, atyre nuk ka thënë që është prishje e gypave me tendencë ose pa tendencë.

**Lumnije Krapi- Drejtoreshë e shëndetësisë**: tash ne e dimë që procedurat e prokurimit sa janë të zgjatura për me përfundu projektin.

Mirëpo, esenca është se standardi numër një është mungesa e ujit.
Nëse në një institucion shëndetësor s'ka ujë, që ky ka qenë që inspektorati e mbyllë menjëherë brenda ditës.

**Hamit Kastrati:** Aty e kemi edhe një mungesë të punëtorit teknik, a duhet me pastru mjekët apo kush atë objekt, kush është punëtori teknik, ata janë hapur për shembull për pacientët, jo për me pastru AMF-në në Nekoc pasi të përfundon orari i punës.
Ato edhe bënë pastrimi shumë rrallë.

**Lumnije Krapi- Drejtoreshë e shëndetësisë:** në asnjë institucion shëndetësor nuk e kemi pastruesit nga për një ambulancë, është në bazë të metrave katror.

**Hamit Haxhiu:** Drejtoresh, për ato mos e arsyeto, se problemi është se ti duhet me kanë dijeni për atë punë komplet, domethënë sa i përket shëndetësisë.
Unë e shoh vetë në institucionin tonë ku jemi institucioni më i madhi edukativ arsimor në Komunën tonë janë katër-pesë punëtorë tekniko-shërbyes për pastrim metrave katrorë i kanë për tre-katërfish unë e më tepër.

**Ramiz Lladrovci Kryetari i Komunës:** Na paguajmë për metër katror pastrim, kompaninë e certifikune për atë punën e cila aplikon me marrë tenderin.
Ne jemi në rregull.
Ne na intereson me kry punën pastrimin, për të cilin ia paguajmë me metër katror.
Pra, për metër katror është kompania e cila ka fitu tenderin, veç duhet me na kallëzu dikush që se ka pastru, me shku me vërtetu me ia dhënë vërejtjen kompanisë, edhe mos të mbrojmë edhe me me largu kompaninë krejt.

**Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 14:15 min.**

*Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 27.10.2023 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Fecebook-ut dhe në kanalin YouTube.*

Procesmbajtëse:
Liridona Fejza-Ajazi

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Milaim Hajdari

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
PRANUAR 13 11 2023

| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
|---|---|---|---|
| 1 | Para se të hartohet Plani Strategjik dhe Plani Vjetor duhet që të kryhet një Rivlerësim i rregullt vjetor i rrezikut në mënyrë që këto plane të jenë tërësisht të bazuara në rrezik. | Njësia e Auditimit (hartimi i planeve)<br>Kryetari i Komunës (miratim), dhe Komiteti i Auditimit (miratim).<br>Njësia e Auditimit (hartimi i planeve)<br>Kryetari i Komunës (miratim), dhe Komiteti i Auditimit (miratim). | 1 | | | Plani Strategjik për vitet 2023-2025 nr. 01-030-69935 i dt. 27.12.2022 . Plani vjetor I Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 me nr. 01-030-69948 I dt. 27.12.2022 | Njësia e Auditimit të brendshëm ka hartuar planin strategjik të bazuar në rrezik për vitet 2023 - 2025 dhe të njejtin e ka aprovuar tek Kryetari I Komunës dhe Komitetit të Auditimit të Brendshëm me dt. 27.12.2022dhe nr protokollit 01-030-69935. NJAB ka hartuar planin vjetor të angazhimit të kapaciteteve audituese për vitin 2023 dhe e ka apriovuar atë nga ana e.Kryetarit të Komunës dhe Komitetit të Auditimit të Brendshmëm me dt. 27.12.2022 me nr të prot. 01-030-69948 |
| 2 | Auditimi nw personel dhe nw buxhet | NJAB | 1 | | | Raporti I Auditimit me nr. 052/01-23396 I dt. 17.05.2023. Kërkesa për takimin fillestar me nr. 01-100/01-52267 e dt. 20.10.2022 | NJAB gjatë vitit 2023 ka kryer Auditim në fushën e personelit dhe ka raportuar me datën 17.05.2023 me raport me nr prot. 01-052-01-23396 , ndërsa në fushën e shpenzimit të buxhetit është duke kryer Auditim dhe për momentin jemi në fazën e ekzaminimit të mostrave.Ky auditim ka filluar me 20.10.2023 me kërkesën për takim fillestar me numër 01-400/01-52267 |
| 3 | Rritja e resurseve njerwzore edhe pwr sw paku njw Auditor | NJAB - Kryetari I Komunws dhe zyra e Personelit | | 1 | | Plani Strategjik për vitet 2023-2025 nr. 01-030-69935 i dt. 27.12.2022 | Me Planin Strategjik për vitin 2023-2025 , si dhe me planin vjetor për zhvillimin e Aktiviteteve Audituese për vitin 2023 është kërkuar shtimi I resursev në fushën e Auditimit si dhe kjo do të bëhet në mënyrë të vazhdueshme derisa kapacitetet humane të plotësohen në tërësi. |
| 4 | Njësia e Auditimit të Brendshëm në fund të çdo viti do të kryej një rivlerësim të rregullt vjetor të rrezikut duke marrë parasysh të gjitha ndryshimet që kanë ngjarë në ndryshimin e kompetencave të komunës, ndryshimin e strukturës, dhe ndryshimin e prioriteteve. | NJAB dhe tw gjitha drejtoritw | 1 | | | Rivlerësimi I rregullt vjetor I rrezikut për hartimin e Planit strategjik për vitet 2024-2026 | NJAB në fund të vitit 2022 ka kryer vlerësimin e rrezikut dhe në bazë të këtij vlerësimi ka bërë planifikimin strategjik dhe vjetor. Tani jemi në fazën e rregullt vjetore të rrezikut për të hartuar Planin Strategjik për vitet 2024-2026 si dhe Planin Vjetor për vitin 2024 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Njësia e Auditimit të Brendshëm në baza të rregullta tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore do të raportoj para Komitetit të Auditimit të Brendshëm në lidhje me gjendjen e rekomandimeve të dhëna | Komiteti i Auditimit të Brendshëm, Kryetari i Komunës Njësia e Auditimit të Brendshëm, Të gjitha drejtoritë | 1 | | | Raporti gjashtëmujor i implementimit te rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2023me nr. 01-052/01-30848. | NJAB ka bërë Rportimin mbi gjendjen e implementimit të rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2023 dhe ka raportuar para Komitetit të Auditimit të brendshëm me dt 29.06.2023 me raportin nr 01-052/01-30848 Tani jemi në përgaditjen e raportimit vjetor deri me dt 31.12.2023 |
| 6 | Definimi i qartë i Universit të Auditimit me Planin Strategjik duke përfshirë të gjitha programet, aktivitetet dhe sistemet që ekzistojnë në komune | NJAB | 1 | | | Plani strategjik ku janë të radhitura 26 sisteme te Auditimit të cilat e përbejnë Universin e Auditimit. | Me Planin Strategjik I cili azhurohet për cdo vit bëhet edhe përcaktimi I Universit të Auditimit I cili nga viti ne vit nuk është se ka ndryshim të dukshme meqë stuktura dhe kompetencat e Komunës nuk ndryshohen shumë shpesh. Për vitin 2023 sipas Universit të Auditimit për Komunën tonë kemi 26 sisteme të Auditimit të cilat e përbëjnë Universin e Auditimit |
| 7 | Auditime të shpeshta në lëminë e shpenzimeve të buxhetit | NJAB | 1 | | | Raporti i auditimit të te hyrave vetanake ne sektorin e Administratës Komunale, Shëndetësisë dhe Arsimit nr 01.052/01-30188 | Sipas Planit vjetor të punës gjithëtere parashifen të kryhen auditime të cilat e rrisin shkallën e integritetit të pasqyrave vjetore financiare të komunës duke kryer auditime në fushen e të hyrave dhe në fushen e shpenzimeve |
| 8 | Raportimi mbi gjendjen e rekomandimeve të dhëna nga ana e auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm. Zhvillimi i një Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Raportimin e rregullt mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit | Komiteti i Auditimit, Kryetari i Komunës, Njësia e Auditimit të Brendshëm, Drejtorët e Drejtorive | 1 | | | Planet e Implementimit pas çdo auditimi që kryhet. Proqesverbalet e mbledhjeve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm për çdo tre muaj. | Pas çdo auditimi, kërkohet Plani i implementimit nga ana e menaxhmentit dhe mandej me kontrolla të herëpashershme konstatohet implementimi, apo mosimplementimi dhe vonesat në implementim. Këto të dhëna i raportohen Kryetarit të Komunës dhe Komitetit të Auditimit të Brendshëm i cili edhe nxjerr konkluzione mbi veprimet që duhet ndërmarrur për shtimin e implementimit të rekomandimeve. |
| 9 | Të përmirësohet sistemi i komunikimit mes njësisë së auditimit të brendshëm dhe organeve të tjera komunale. Vështrësi në komunikim kohe pas kohe mund te ketë me drejtorët e drejtorive komunale | Kryetari i Komunës, Komiteti i Auditimit, Njësia e AB, Komiteti i Auditimit dhe Drejtorët e Drejtorive | 1 | | | Lista e pjesemarrjes së menaxherëve te komunes në mbledhjet e Komitetit të Auditimit si dhe pjesëmarrja e rregullt e Kryatarit në këto mbledhje. | Gjatë të gjitha mbledhjeve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm kanë marrur pjesë të gjith menaxherët e drejtorateve të cilat janë audituar dhe që Raporti i tyre i auditimit është shqyrtuar në atë mbledhje. Poashtu edhe Kryetari i Komunës në mënyrë të vazhdueshme merr pjesë në këto mbledhje dhe kështu krijohet mundësia e një bashkëpunimi më të mirë në mes të audituarve, Njësisë së Auditimit të Brendshëm, Komitetit të Auditimit dhe Menaxhmentit më të lartë të Komunës |
| 10 | Të aplikohen tri qasjet e auditimit që janë të parapara edhe në Planin Strategjik duke përfshirë Qasjen funksionale, strukturore dhe qasjen e kombinuar | NJAB | 1 | | | Plani strategjik dhe plani vjetor i cili tri qasjet e mundshme te auditimit. | Njësia e Auditimit të Brendshëm nga tri mundësitë që ka për të zgjedhur qasjen e auditimit ( qasja funksionale, qasja strukturale, dhe qasja e kombinuar) në çdo auditim ka zgjedhur qasjen e kombinuar për arësye se është qasje që siguron një pasqyrë më të mirë mbi gjendjen e autoritetit të audituar dhe është qasje më reale. |
| | | | | | | | |
| | | | 9 | 1 | 0 | | |
| | | | 90.00% | 10.00% | 0.00% | | 100.00% |

## Menaxhimi i pronës komunale

| | Përshkrimi i Mases TM 1 - 2 | Njësia përgjegjëse | E përfunduar | Është në proces | Ende ska filluar | Deshmia | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Të formohet një komision për monitorimin e pronave komunale të lëshuara në shfrytëzim | Zyra e Kryetarit | 1 | | | Vendimi nr.01-020/01-13711 dt.20.04.2023 dhe nr.01-020/04-13832 dt.20.03.2023 | |
| | | | | | | | |
| | | | 1 | 0 | 0 | | |
| | | | 100.00% | 0.00% | 0.00% | | 100.00% |

## Prokurimi Publik

| | Përshkrimi i Mases TM 1 - 2 | Njësia përgjegjëse | E përfunduar | Është në proces | Ende ska filluar | Deshmia | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Identifikimi i nevojave për trajnime për zyrtaret që përfshihen në procedurat e prokurimit publik | Zyra e Prokurimit dhe NJBNJ | 1 | | | Çertifikata për prokurim publik nga KRPP | |
| 2 | Caktimi i stafit profesional, të certifikuar dhe ofrimi i trajnimeve për menaxhim të kontratave | Drejtoria për Administratë dhe NBNJ | 1 | | | ZP ka të certifikuar zyrtaret për prokurim publik. Njësitë Kërkuese vazhdimisht përcjellin trajnimet që kanë të bëjë me menaxhim të kontratave dhe I dërgojnë në trajnime | |
| 3 | Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e specifikimeve të tenderit. Hartimi i projekteve detale | Të gjitha drejtoritë dhe Zyra e Prokurimit | 1 | | | Hartimi I projekteve për nevojat e komunes se Drenasit. Projekt 3 vjeçar. Nr 611-23-6859-211 | |
| | | | | | | | |
| | | | 3 | 0 | 0 | | |
| | | | 100.00% | 0.00% | 0.00% | | 100.00% |

## Urbanizmi dhe Planifikimi Hapësinor dhe Inspektorat

| | Përshkrimi i Mases TM 1 - 2 | Njësia përgjegjëse | E përfunduar | Është në proces | Ende ska filluar | Deshmia | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Të miratohet rregulloret e brendshme komunale duke përcaktuar kriteret e qarta që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural | DPUMM | | 1 | | Implementohet brenda viteve 2023 2024. Linku për rregulloren për taksa, tarifa dhe gjoba chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/10/Draft-propozim-vendimi-per-ndryshimin-plotesimin-e-rregullores-per-taksa-tarifa-ngarkesa-dhe-gjoba.pdf | Implementohet brenda viteve 2023 2024 |
| 2 | Të organizohen trajnime profesionale në fushën e zbatimit dhe mbikëqyrjes së dokumenteve të planifikimit hapësinor | DPUMM Njësia e burimeve njerezore | | 1 | | Ftesa në puntori të ndryshme, trajnime, (IKAP, DEMOS) etj. | Vazhdimësi |
| 3 | Të planifikohet rekrutimi i stafit të mjaftueshëm të inspektorëve | Drejtoria e Inspekcionit Njësia e Burimeve Njerëzore | | 1 | | Janë plotësuar sipas : Konkursit Publik Nr Referencës RN0011563 - Inspekor i Shërbimeve Publike, dhe Nr References RN0012380 - Inspekor i Mrojtjes së Mjedisit | |
| 4 | Të sigurohet personel adekuat profesional kontrollimin e ndërtimeve | Drejtoria e Inspekcionit | 1 | | | Për çdo fund vit D Inspeksionit - Aktualisht Komuna posedon 2 inspektor të Ndërtimit mirëpo pasiqë njëri nga inspektoret është në pushim të lehonisë, nuk ka mundur të bëhet planifikim I detaj ar sepse Inspektori pritet te kthehet nga pushimi. Inspektorati Komunal gjegjesisht fëmia e ndërtimit zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nenligjore si dhe rregulloret e brendshme të përcaktuara të Komunës | |
| 5 | Lejimi i vendeve të reja të punës sipas kërkesave të NJK për mbulimin e të gjitha fushave inspektuese që bien nën domenin e DI. | Njësia e Burimeve Njerëzore | 1 | | | Drejtoria ka planifikuar edhe rekrutimin e 2 inspektoreve shtesë në fëmi të ndryshme varësisht nga nevojat që dalin si rezultat I kërkesave qytetare gjegjësisht komunale. | |
| | | | | | | | |
| | | | 2 | 3 | 0 | | |
| | | | 40.00% | 60.00% | 0.00% | | 100.00% |

## Rekrutimi, Ofrimi i Shërbimeve në Shëndetin Publik

| | Përshkrimi i Mases TM 1 - 2 | Njesia përgjegjëse | E përfunduar | Është në proces | Ende ska filluar | Deshmia | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pajisja me kartela shëndetësore, ndarja zonale dhe lista e pacientëve. Aprovimi i Rregullores së brendshme për sistematizimin e vendeve të punës. | Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe KPSH | | 1 | | Rregullorja është miratuar në dt 07.07.2023 nga Keshilli Drejtues i QKMF-së. Nr.protokoli 583 dt 14.07.2023 | |
| 2 | Hartimi i programeve lidhur me edukimin dhe promovimin shëndetësore në komunitet. | DSHMS KPSH | | 1 | | Mbahen aktivitet per edukim dhe promovim vetëm për ditet e shënjuara ndërkombëtare https://kk.rks-gov.net/gllogoc/news/njoftim-tetori-muaji-nderkombetar-i-luftes-kunder-kancerit-se-gjirit<br>https://kk.rks-gov.net/gllogoc/lajmet<br>https://www.facebook.com/photo/?fbid=827470725850855&set=pcb.827471315850796<br>https://www.facebook.com/photo/?fbid=824012949529966&set=a.397973502133515<br>https://www.facebook.com/photo/?fbid=813364587261469&set=pcb.813365757261352<br>https://www.facebook.com/photo/?fbid=774250044506257&set=a.397973495467249<br>https://www.facebook.com/photo/?fbid=746927080571895&set=pcb.746928077258454 si dhe Libri i QKMF-së Nr 341 dt16.05.2023 | |
| 3 | Planifikimi i buxhetit dhe hartimi me kohë i projekteve, investimeve | DSHMS | 1 | | | Janë pajisur me Klima pothuajse të gjitha qendrat shendetesore si dhe janë funksionalizuar pjerrinat nëpër ato QMF ku nuk ka pasur( Raporti I komisionit për pranim teknik të punimeve I dt. 28.07.2023 si dhe Raport përfundimtar 17.07.2023 nr kontratës 02-400 25410 me nr prokurimi 611-23-3719-521 | |
| 4 | Implementimi i UA 04/2020 (1 mjek dhe 2 infermierë në 2000 banorë si dhe një stomatolog në 1000 banorë | DSHMS QKMF | 1 | | | Konkursi 06-111 01-6665 dt 23.02.2023 e fundit janë pranuar 3 Stomatolog dhe 9-mjek Vendimi Nr 370 dt 22.05.2023. Duke qenë se çdo vitë mjekët shkoin për specializime kjo planifikohet të plotësohet çdo vit | |
| | | | | | | | |
| | | | 2 | 2 | 0 | | |
| | | | 50.00% | 50.00% | 0.00% | | 100.00% |

## Rekrutimi i Stafit dhe Mirëmbajtja në Arsimin Publik

| | Përshkrimi i Mases TM 1 - 2 | Njesia përgjegjëse | E përfunduar | Është në proces | Ende ska filluar | Deshmia | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | DKA nuk do të shpallë konkurse të reja, fillimisht, do të sistemohen mësimdhënës që mbesin pa normë si pasojë e rënies së numrit të nxënësve | DKA dhe Shkollat | 1 | | | Gjatë vitit 2023 në të gjitha rastet kur ka qënë e mundur shpemdarja e orëve, DKA nuk ka shpallur konkurs për mesimdhenesit që kanë dalur në pension ose që për arsye të ndryshme i është ndërprerë mardhënja e punës. Në vitin 2023, nga 29 mësimdhënës që kanë daluar në pension 15 prej tyre nuk janë zavendësuar me staf të ri. Deshmi lista e mësimdhëneseve që kanë dalur në pension ose që për arsye të ndyshme ju është shkeputur kontrata dhe lista e konkurseve të shpallura | |
| 2 | Marrja e masave për zëvendësimet adekuate nga stafi ekzistues të cilët kanë mungesë të normave | DKA dhe Shkollat | 1 | | | Gjatë vitit 2023 në të gjitha rastet kur ka qënë e mundur shpemdarja e orëve për mesimdhënëset që kanë shkuar në pushim të lehonis, DKA ka angazhuar edhe mësimdhënës mbi normë ( me orë shtesë ). Deshmi formularet e orëve shtesë të derguar në divizionin e pagave në Qershor dhe Tetor 2023 | |
| | | | 2 | 0 | 0 | | |
| | | | 100.00% | 0.00% | 0.00% | | 100.00% |

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Gllogovc / Municipality of Drenas / Gllogovc
Komisioni për Zgjedhjen e këshillave Lokale

**01 Nr.** -052101 - 56187 **dt.** 15/11/**2023**

| | |
|---|---|
| **DATË:** | 15.11.2023 |
| **PËR:** | **Kuvendin Komunal të Komunës së Drenasit** |
| **CC:** | **Kryetarin e Komunës së Drenasit**<br>**z. Ramiz Lladrovci** |
| **NGA:** | **Arben Shala**<br>Nënkryetar i Komunës në emër të Komisionit |
| **LËNDA:** | **Raport për përfundimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave Lokale në Komunën e Drenasit** |

**Kronologji e shkurtër**

Duke vepruar në bazë të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 *Për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane* Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me 27.07.2022 ka miratuar rregulloren me numër Nr. 02-030/01-38622, ndërsa në mbledhjen e mbajtur më datë 27.10.2022 ka marrë vendimin me numër Nr. 02-020/04-56133 per formimin e Komisionit sipas përbërjes si më poshtë (sipas renditjes alfabetike):

1. Arben Shala, nga ekzekutivi,
2. Beqir Kiqina, nga legjislativi,
3. Egzona Tërdevci, nga legjislativi,
4. Fatmir Baliu, nga legjislativi,
5. Hamit Haxhiu, nga legjislativi,
6. Shqipe Hoxha, nga shoqëria civile, dhe
7. Një anëtar nga përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve apo lagjet urbane.

Komisioni ka mbajtur mbledhje më datë 06.02.2023 dhe ka marrë vendim që të fillojë procedura e zgjedhjes duke u dhënë fillimisht prioritet këshillave lokale në përbërje me nga një lokalitet e pastaj të vazhdohet me ato që kanë dy apo tri lokalitete. U dakordua për kohën e takimeve, ora 18.30, e njëjtë për të gjitha takimet zgjedhore.

Në mbledhjen e Komisionit të mbajtur me datë 28.03.2023, ndër të tjera u vendos që të fillohet me zgjedhjen e këshillave lokale pas Ramazanit. procedurat e zgjedhjes duke caktuar tri ditë në jave (të hënën, të mërkurën dhe të premten). Gjatë ditëve në vijim u hartua dhe prezantua orari me të cilin pajtuan anëtarët e Komisionit.

Orari zgjedhor u postua në faqen dhe rrjetin social zyrtar të komunës dhe në bazë të rregullores, të gjitha njoftimet kanë respektuar afatin i paraparë të njoftimit dhe zakonisht janë përsëritur një ditë para procesit zgjedhor.

Për lehtësim komunikimi në mes të anëtarëve të Komisionit është krijuar një grup në WhatsApp.

**Procesi zgjedhor**

- Të përgjithshme

Janë mbajtur gjithsej 32 takime për 32 ditë, tri herë në javë: të hënën, të mërkurën dhe të premten për 6 muaj. Komisioni ka pushuar aktivitetet për dy javë gjatë muajit qershor, festave zyrtare dhe gjatë tërë muajit gusht.

Zgjedhjet për tri këshilla lokale janë mbajtur nga 3 herë, ku hera e tretë ka rezultuar e suksesshme: Abri, Drenas I dhe Drenas II.

Për Gradicë dhe Likoshan kryesuesi dhe kryesia e këshillit lokal janë zgjedhur për herë e dytë.

Tjerat janë zgjedhur herën e parë.

Në të gjitha mbledhjet të pranishmit janë njoftuar për arsyet e reduktimit të këshillave lokale nga 44 në 25, gjithashtu me dispozita të rregullores për procedurat për zgjedhjen e kryetarit dhe kryesisë së këshillit lokal, për raportet që priten dhe për kohëzgjatjen dhe pushimin eventual të mandatit.

Në të gjitha mbledhjet e suksesshme kanë qenë të pranishëm më shumë se 41 persona, në përputhje me rregullore. Duhet theksuar, megjithatë, se ka pasur vështirësi në sigurimin e kuorumit të mjaftueshëm. Kjo çështje kërkon ndryshim plotësimin e rregullores përkatëse sa i përket numrit të kuorumit me rastin e dështimit të herës së parë për zgjedhjen e këshillit lokal.

Procesi zgjedhor është zhvilluar në mënyrë transparente në përputhje të plotë me rregulloren. Kutia e votimit ka qenë gjithmone e dukshme për pjesëmarrësit dhe numërimi i votave (aty ku ka pasur votime) është kryer në prani të qytetarëve. Gjatë tërë procesit nuk ka pasur asnjë incident fizik brenda objekteve ku janë mbajtur zgjedhjet.

- Angazhimi i anëtarëve të Komisionit

Në përgjithësi, shumica dërmuese e anëtarëve të Komisionit kanë treguar përkushtim në pjesëmarrjen në zgjedhje duke munguar vetëm në rast të sëmundjeve apo rrethanave të pashmangshme.

Mungesat e anëtarëve të Komisionit janë si më poshtë:

1. Arben Shala, nga ekzekutivi, 1 mungesë
2. Beqir Kiqina, nga legjislativi, 5 mungesa
3. Egzona Tërdevci, nga legjislativi, 15 mungesa
4. Fatmir Baliu, nga legjislativi, 5 mungesa
5. Hamit Haxhiu, nga legjislativi, 3 mungesa
6. Shqipe Hoxha, nga shoqëria civile 8 mungesa

- <u>Këshillat Lokale</u>

Komisioni ka filluar mbledhjen e parë në fshatin Kizharekë më datë 27.04.2023 dhe të fundit e ka mbajtur më 06.10.2023 në Abri.

Kryesuesit dhe përbërjet e këshillave lokale të zgjedhur kanë përbërjen e mëposhtme:

| **Nr. rendor** | **Këshilli Lokal (sipas alfabetit)** | **Lokalitet/ Vendbanimet që përbëjnë K.L.** | **Numri i banorëve sipas vitit 2011** | **Kryesuesi i K.L. të zgjedhur** | **Numër Telefoni** | **Përbërja e K. Lokal** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Abria e Epërme | Abria e Epërme | 1779 | Dardan Hysenaj | 049469094 | Ukë Hajdaraj, Shqipdon Demaj, Shefshet Delijaj, Pajtim Halilaj, dhe Kushtrim Halilaj. |
| | | Tërdevci | 1121 | | | |
| 2 | Arllat | Arllati | 3421 | Shumzim Bujupi | 044847354 | Jeton Bujupi, Agim Bujupi, Arton Bujupi, Jakup Bytyqi, Rexhep Gashi dhe Blerim Gashi. |
| | | Gjergjaj | | | | |
| | | Bytyq | | | | |
| 3 | Baicë | Baica | 2306 | Semedin Kiqina | 044842361 | Fisnik Leku, Xhemë Kiqina, Nebih Xhylani, Agim Zariqi, Bashkim Elshani dhe Naim Topalli. |
| 4 | Drenasi I | Drenasi I | 6122 | Habib Tahiraj | 049929884 | |
| 5 | Drenasi II | Drenasi II | | Jahir Beqiri | 044951306 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Lagjja e Feronikelit | | | | Lulzim Seferi, Bekim Mala, Shpetim Heta, Besnik Hasi, Driton Qorri dhe Adem Kiqina |
| 6 | Drenasi III (Çikatovë e Re) | Drenasi III | 2221 | Fatos Prokshi | 045255844 | Arif Heta, Kujtim Halilaj, Arizona Ajrizaj, Jetmir Baleci, Mehmet Fazliu dhe Nebih Bajraktari |
| 7 | Dobroshevc | Dobroshevc | 1457 | Xhevdet Shishani | 044287244 | Fadil Prenku, Miftar Avdyli, Qerim Berbatovci, Bislim Berbatovci, Bujar Dervishi Dhe Fatlum Morina |
| | | Çikatovë e Vjetër | 1261 | | | |
| | | Godanc | 357 | | | |
| 8 | Gllobar | Gllobari | 1526 | Murat Elshani | 044181108 | Arif Heta, Kujtim Halilaj, Arizona Ajrizaj, Jetmir Baleci, Mehmet Fazliu dhe Nebih Bajraktari |
| 9 | Gllanasellë | Gllanasella | 1591 | Eshref Nika | 049361461 | Agim Krasniqi, Shaban Berisha, Amir Karaqica, Islam Topilla, Durim Lladrovci dhe Mehmet Kurrumeli. |
| 10 | Gradicë | Gradica | 845 | Hafiz Muja | 044118641 | Dibran Dibrani, Jeton Saliuku, Fatmir Fazliu, Hysen Avdyli, Atdhe Qerimi dhe Fitor Tahiri. |
| | | Likoshani | 600 | | | |
| 11 | Kizharekë | Kizhareka | 1505 | Ymri Bajraktari | 044201296 | Ylber Fana, Ramadan Rrukiqi, Albenit Ramadani, Hamit Demiri, Muhamet Murseli dhe Arben Zeka. |
| 12 | Komoran I | Komorani I | 4400 | | 044171084 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Komorani II | | Besim Nishori | | Kushtrim Zogu, Faik Ibriqi, Labinot Nishori |
| 13 | Komoran II | Komorani III | | Nasuf Mulaku | 044874149 | Sali Berisha, Dush Nishori, Florim Ibrahimi, Florim Rexha, Dardan Bogiqi dhe Atdhe Bogiqi. |
| | | Komorani IV | | | | |
| 14 | Korroticë e Epërme | Korrotica e Epërme | 972 | Xhafer Doberdolani | 044261231 | Besart Hoxha, Nazif Shabani, Alban Doberdolani, Fahredin Hajdin, Berat Rexhepi, dhe Murat Imeri |
| | | Zabeli i Epërm | 565 | | | |
| 15 | Korroticë e Poshtme | Korrotica e Poshtme | 972 | Blerim Sinani | 044 950 001 | Hysni Ramadani, Hysen Hyseni, Labinot Ramadani dhe Florim Shala |
| | | Zabeli i Poshtëm | 1077 | | | |
| 16 | Krajkovë | Krajkova | 1181 | Arben Haziri | 044164199 | Tahir Hoxha, Xhemajl Bytyqi dhe Agron Elshani; kurse për fshatin Damanek janë: Kastriot Hoxha, Behar Haradini dhe Edmond Jetullahu |
| | | Domaneku | 715 | | | |
| 17 | Llapushnik | Llapushniku | 3433 | Ramadan Gashi | 044215638 | Bashkim Thaqi, Nazmi Berisha, Nasuf Gashi, Fadil Thaqi, Urim Gashi dhe Ramiz Sopa |
| 18 | Negroc | Negroci | 1536 | Xhevdet Krasniqi | 044215772 | Albert Shala, Sadri Shala, Sami Haziraj, Faik Krasniqi, Behxhet Krasniqi dhe Bledar Shala. |
| | | Vuçaku | 369 | | | |
| 19 | Nekoc | Nekoci | 2649 | Habib Gashi | 044191130 | Ylber Fana, Ramadan Rrukiqi, Albenit Ramadani, Hamit Demiri, Muhamet |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Murseli dhe Arben Zeka. |
| 20 | Poklek | Pokleku i Vjetër | 1966 | Zeke Kluna | 044296399 | Isuf Shishani, Rrahim Nebihu, Sabit Muqolli, Fatmir Bucolli, Jetlir Berisha dhe Haki Berisha |
| | | Poklek i Ri | | | | |
| | | Vasileva | 634 | | | |
| 21 | Polluzhë | Polluzha | 1017 | Arbnor Istogu | 044207372 | Vlorsim Istogu, Blendina Veliqi, Haki Kastrati dhe Izet Maloku. |
| 22 | Sankoci | Sankoci | 1436 | Kadri Ajazi | 044613079 | Hetem Ajazi, Muhamet Rama, Qendresë Xhema, Osman Bahtiari, Izet Bytyqi dhe Naser Ramadani |
| | | Fushtica e Epërme | 984 | | | |
| | | Fushtica e Poshtme | 1062 | | | |
| 23 | Shtrubullovë | Shtrubullova | 1105 | Hajrush Musliu | 044256828 | Besjan Murtezi, Avdyl Gashi, Gëzim Hajrizi, Albert Shabani, Sami Musliu dhe Sali Rexhepi |
| 24 | Tërstenik | Tërsteniku I | 3904 | Bajram Qallapeku | 049860302 | Agim Kacurreti,Samedin Bylykbashi, Agron Gashani, Arben Bazaj, Shaip Arllati dhe Halim Mulaj |
| | | Tërsteniku II | | | | |
| 25 | Vërboc | Vërboci | 1190 | Islam Syla | 049978625 | Valdet Gllareva, Avni Gashi, Fitim Istogu, Durim Zejnullahu, Agron Berisha, dhe Beni Muslija. |
| | | Shtutica | 934 | | | |

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Zyra e Kryetarit
**01 Nr.** 400/01-56151 **dt.** 15.11.**2023**

Në vështrim të nenit 13, dhe 58, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon që në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1, 12.2 pika d, dhe nenit 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Nr. 12-320-19338, dt. 7.4.2017, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.4.2022, si dhe Kërkesës të Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave, Nr.01-070/01-55987, të datës 14.11.2023, për Kuvendin e Komunës, Kryetari i komunës, jep këtë:

# PROPOZIM VENDIM
## mbështetje financiare

### Neni 1
Aprovohet kërkesa e Qendrës për Promovimin e Drejtave të Grave, Nr. 01-070/01-55987, të datës 14.11.2023, për ndihmë financiare për këtë qendër, në shumën prej 3,000.00 euro, nga kategoria e shpenzimeve: Subvencione dhe transfere.

### Neni 2
Mjetet financiare të aprovuara sipas këtij Vendimi do të paguhen nga pozicioni, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, të parapara me buxhetin e vitit 2023.

### Neni 3
Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Drenasit.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO - MUNICIPALITY - KOMUNA GLLOGOC

**Kryetari i Komunës**

**Ramiz Lladrovci**

Ju dërgohet:
- Zyrës së Kryetarit
- Zyrës së Kuvendit të Komunës

## ARSYETIM

Pranë Zyrës së Kryetarit, është adresuar kërkesa e Qendrës për Promovimin e Drejtave të Grave, Nr. 01-070/01-55987, të datës 14.11.2023, ku është parashtruar nevoja për mbështetje financiare për këtë qendër.

Komuna e Drenasit brenda kompetencave të saja ligjore dhe buxhetore, e ka të rregulluar këtë çështje përmes Rregullores se brendshme komunale - Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 si dhe rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.04.2022 e cila parasheh se Komuna subvencionon në formë të përkrahjes financiare OJQ-të, sipas kritereve të përcaktuara me të njëjtin dokument/rregullore, ku edhe duke u bazuar në këtë, përmes këtij dokumenti, propozohet që në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda kompetencave, Kryetari propozon të aprovohet kërkesa e cekur më lartë.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosova**
**Komuna Drenasit**
**Municipality Drenas**
**Zyra Kryetarit**
01 Nr.400-55134 dt.08.11 2023

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1pika (h) të ligjit për vetëqeverisje lokale nr 03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 5 pika 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2016 Për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës''), nenit 4,7,8,9 të udhëzimit administrativ Nr.01/2016 për procedurat e themelimit, organizimit dhe kompetencat e komiteteve konsultative në Komuna, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë ___________ jep këtë:

## Propozim vendim

## Për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetin Konsultativ Komunal për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

### Neni 1

Më këtë Propozim i Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës formimi i panelit përzgjedhës, i cili do të zhvilloj procedurat për themelimin e komitetit konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve

### Neni 2

Kuvendi ka për obligim të themelon panelin përzgjedhës, i cili duhet të ketë në përbërje tre anëtare të kuvendit të komunës, një anëtarë nga ekzekutivi i komunës dhe një anëtarë nga shoqëria civile, që do t'i propozojnë kuvendit të komunës listën me anëtarë për komitetin konsultativ.

### Neni 3

Për zgjedhjen e anëtarëve në komitetin konsultativ kuvendi i komunës shpall konkurs publik dhe përcakton kriteret për konkurrim.

### Neni 4

Mandati i komitetit konsultativ pas përzgjedhjes është 4 vjeçar, nga themelimi i komitetit.

**Neni 5**

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Kryetari i Komunës**
**Ramiz Lladrovci**

Arsyetim

Komuna Drenasıt Respektivisht Kryetari i Komunës duke pasur parasysh që komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini, dhe Sport nr. 12.020-56967 dt. 27.09.2019 të Kuvendit të Komunës të Kuvendit të komunës i ka përfunduar mandati në bazë të nenit 9 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna.

Duke u Bazuar në nenin 8 pika 3 në Udhëzimin Administrativ nr. 01/2016 Për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna paneli përzgjedhës duhet të jetë në përbërje prej 5 anëtareve, ku 3 anëtar nga Kuvendi Komunal, 1 anëtar nga ekzekutivi i komunës dhe 1 anëtar nga shoqëria civile.

Paneli përzgjedhës zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ duhet ta bëjë në përputhje të plot me udhëzimin administrativ për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Zyra Kryetarit
01 Nr.- 400/01-55/83 dt. 08/11/ 2023

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1pika (h) të ligjit për vetëqeverisje lokale nr 03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 5 pika 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2016 Për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 4,7,8,9 të udhëzimit administrativ Nr.01/2016 për procedurat e themelimit, organizimit dhe kompetencat e komiteteve konsultative në Komuna, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë ___________ jep këtë:

## Propozim vendim
## Për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetin Konsultativ Komunal për Persona me Aftësi të kufizuara

### Neni 1
Më këtë Propozim i Vendim i propozohet Kuvendi i Komunës formimi i panelit përzgjedhës, i cili do të zhvilloj procedurat për themelimin e komitetit konsultativ për Persona me Aftësi të kufizuara, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve

### Neni 2
Kuvendi ka për obligim të themelon panelin përzgjedhës, i cili duhet të këtë në përbërje tre anëtare të kuvendit të komunës, një anëtarë nga ekzekutivi i komunës dhe një anëtarë nga shoqëria civile, që do t'i propozojnë kuvendit të komunës listën me anëtarë për komitetin konsultativ.

### Neni 3
Për zgjedhjen e anëtarëve në komitetin konsultativ kuvendi i komunës shpall konkurs publik dhe përcakton kriteret për konkurrim.

### Neni 4

Mandati i komitetit konsultativ pas përzgjedhjes është 4 vjeçar, nga themelimi i komitetit.

**Neni 5**

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO - KOMUNA GLLOGOC - MUNICIPALITY GLLOGOC

**Kryetari i Komunës**
**Ramiz Lladrovci**

Arsyetım

Komuna Drenasit Respektivisht Kryetari i Komunës duke pasur parasysh që komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të kufizuara, sipas vendimit nr. 12.020-56967 dt. 27.09.2019 të Kuvendit të Komunës të Kuvendit të komunës i ka përfunduar mandati në bazë të nenit 9 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna.

Duke u Bazuar në nenin 8 pika 3 në Udhëzimin Administrativ nr. 01/2016 Për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna paneli përzgjedhës duhet të jetë në përbërje prej 5 anëtareve, ku 3 anëtar nga Kuvendi Komunal, 1 anëtar nga ekzekutivi i komunës dhe 1 anëtar nga shoqëria civile.

Paneli përzgjedhës zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ duhet ta bëjë në përputhje të plot me udhëzimin administrativ për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosova**
**Komuna Drenasit**
**Municipality Drenas**
**Zyra Kryetarit**
01 Nr.100-55121 dt.08.11 2023

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1pika (h) të ligjit për vetëqeverisje lokale nr 03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 5 pika 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2016 Për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 4,7,8,9 të udhëzimit administrativ Nr.01/2016 për procedurat e themelimit, organizimit dhe kompetencat e komiteteve konsultative në Komuna, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë ___________ jep këtë:

## Propozim vendim
## Për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetin Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

### Neni 1
Më këtë Propozim i Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës formimi i panelit përzgjedhës, i cili do të zhvilloj procedurat për themelimin e komitetit konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve

### Neni 2
Kuvendi ka për obligim të themelon panelin përzgjedhës, i cili duhet të ketë në përbërje tre anëtare të kuvendit të komunës, një anëtarë nga ekzekutivi i komunës dhe një anëtarë nga shoqëria civile, që do t'i propozojnë kuvendit të komunës listën me anëtarë për komitetin konsultativ.

### Neni 3
Për zgjedhjen e anëtarëve në komitetin konsultativ kuvendi i komunës shpall konkurs publik dhe përcakton kriteret për konkurrim.

### Neni 4

Mandati i komitetit konsultativ pas përzgjedhjes është 4 vjeçar, nga themelimi i komitetit.

**Neni 5**

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Kryetari i Komunës**
**Ramiz Lladrovci**

Arsyetim

Komuna Drenasit Respektivisht Kryetari i Komunës duke pasur parasysh që komiteti Konsultativ Për, Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, sipas vendimit nr. 12.020-56961 dt. 27.09.2019 të Kuvendit të Komunës të Kuvendit të komunës i ka përfunduar mandati në bazë të nenit 9 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna.

Duke u Bazuar në nenin 8 pika 3 në Udhëzimin Administrativ nr. 01/2016 Për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna paneli përzgjedhës duhet të jetë në përbërje prej 5 anëtareve, ku 3 anëtar nga Kuvendi Komunal, 1 anëtar nga ekzekutivi i komunës dhe 1 anëtar nga shoqëria civile.

Paneli përzgjedhës zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ duhet ta bëjë në përputhje të plot me udhëzimin administrativ për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Zyra e Kryetarit

**Nr** 01-400/01-55391 **dt.** 09/11/ **2023**

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h)të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit te Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, nenit 3,4 dhe 15 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi:

# PROPOZIMVENDIM

## Për plotësim ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

### Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si në vijim:

- Znj.Feime Bajrami zëvendësohet me z.Driton Morina ( Stacioni Policor Drenas),
- Znj. Gentianë Morina zëvendësohet me znj. Zahrie Podrimqaku-Subashi (Zyrtare për Barazi Gjinore),
- Z.Edolind Vishaj zëvendësohet me znj.Ilirianë Bunjaku (FSK)
- Z. Lumnije Krapi zëvendësohet me z.Nexhmedin Gruda (Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë)
- Z.Haxhi Lladrovci zëvendësohet me z.Bekim Baliu (Komuniteti i Biznesit)

### Neni 2

Detyrat dhe Përgjegjësit e KKSB-së janë të parapara me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

### Neni 3

Mandati i anëtarëve të zëvendësuar është katër (4) vjeçar, ashtu sikurse anëtaret e Kuvendit, si dhe përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLLOGOC - MUNICIPALITY GLLOGOC

**Kryetari i Komunës**

**Ramiz Lladrovci**

**A R S Y E T I M**

Themelimi i Këshillit Komunale për Siguri në Bashkësi është përcaktuar me nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Ndërsa, zëvendësimi i anëtarit të KKSB-së është paraparë me nenin 15 të ligjit të njëjtë.

Meqenëse disa nga anëtarët e KKSB-së kanë ndryshuar pozitat zyrtare, njëherit nga komunitetet si FSK kanë propozuar anëtar të ri, dhe anëtari i komuniteti i biznesit i cili zëvendësohet sipas nenit 15 të udhëzimit të njëjtë, propozohet miratimi i plotësim-ndryshimit të vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi me numër të protokolit 12-030-65514, dt 23.12.2021.

Detyrat dhe Përgjegjësit e KKSB-së janë të parapara me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.